



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 62

Tiranë – E martë, 20 prill 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 38/2021 datë 23.3.2021	Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International Inc.”, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës..... 6197
Ligj nr. 39/2021 datë 23.3.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr. 1, në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH – Shqipëri, llogari bashkëpunimi”..... 6199
Ligj nr. 40/2021 datë 23.3.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së angazhimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (<i>Covax Facility</i>), miratuar me ligjin nr. 134/2020..... 6210
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 16.4.2021	Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet “Human Vaccine” LLC dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën kundër covid-19 “Sputnik V”, të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit <i>Gamaleya</i> për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi..... 6211
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 232, datë 14.4.2021	Për caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organ qendror blerës, për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese <i>Dryocosmus Kuripbilus Hymenoptera: Cynipidae</i> ”..... 6212

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 183/1, datë 8.4.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar...	6212
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 16.3.2021	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2017-1692, datë 26.9.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	6213
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 4703, datë 19.4.2021	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	6222
Udhëzim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. 6, datë 6.4.2021	Për zbatimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 31.3.2021, “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”.....	6223
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 30.3.2021	Mbi licencimin e shoqërisë “Rei – Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjaca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 <i>kw</i> , HEC “Lingjaca 2”, me kapacitet të instaluar 300 <i>kw</i> , me kapacitet total të instaluar 2197 <i>kw</i>	6224
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 84, datë 30.3.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë.....	6226
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 85, datë 30.3.2021	Mbi zgjatjen e afatit të dorëzimit të Programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “Albgaz” sh.a.....	6227
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 86, datë 30.3.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 63, seria NPM08P, dhënë shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar.....	6228
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 87, datë 30.3.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 59, seria NPM08P, dhënë shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar.....	6229
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 88, datë 31.3.2021	Mbi kërkesën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë të OST sh.a. për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të pajtueshmërisë së operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.....	6230
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 89, datë 31.3.2021	Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021”.....	6230
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 7.4.2021	Mbi miratimin e tregueseve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021.....	6235



LIGJ
Nr. 38/2021

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
SË VEÇANTË PËR NEGOCIMIN
DHE EKZEKUTIMIN E KONTRATËS
ME SHOQËRINË “BECHTEL
INTERNATIONAL INC.”, PËR
PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN
E HIDROCENTRALIT TË SKAVICËS**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të autorizojë dhe të përcaktojë procedurën e veçantë për negociimin, ekzekutimin dhe miratimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International Inc.” (në vijim “Bechtel”), ose një filial të tij, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, bazuar në shprehjen e interesit paraprak të depozituar në ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë.

Neni 2
Struktura e kontratës

1. Kontrata me Bechtel-in ndahet në dy faza:

a) kontrata e fazës së parë, e cila përfshin aktivitetet paraprake të punës që do t'i mundësojnë Bechtel-it të paraqesë një propozim tek autoriteti kontraktues për kontratën e fazës së dytë dhe të ndihmojë autoritetin kontraktues e Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë në sigurimin e mbështetjes financiare për projektin; dhe

b) kontrata e fazës së dytë, që konsiston në projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

2. Kontrata e fazës së parë përfshin realizimin e veprimtarive të mëposhtme:

a) matje topografike dhe studime hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit;

b) studime dhe inspektime gjeoteknike në terren;

c) zhvillimin e strategjisë për realizimin e projektit;

ç) rishikimin dhe finalizimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor e social;

d) përgatitjen e projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventimin e kostove dhe të sasive; dhe

dh) shërbime të tjera të dakordësuara për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës.

3. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare kryen opoenencë për veprimtaritë e fazës së parë të paraqitura nga Bechtel-i vetë dhe/ose me anë të institucioneve përgjegjëse shqiptare. Shpenzimet për mbulimin e kontratës së fazës së parë mbulohen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.

Neni 3

Procedura e negociimit të kontratës

1. Kontrata e fazës së parë dhe kontrata e fazës së dytë nënshkruhen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare në cilësinë e autoritetit kontraktues. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë mbikëqyr gjithë procesin nga firmosja e marrëveshjes deri tek ekzekutimi i saj.

2. Procedura e negociimit për finalizimin e kontratës së fazës së parë zhvillohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare dhe fillon brenda 5 (pesë) ditëve nga dita kur Bechtel-i dorëzon pranë Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare propozimin zyrtar për kontratën e fazës së parë.

3. Propozimi zyrtar i Bechtel-it dorëzohet 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) javë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas nenit 5 të tij. Palët negociojnë dhe dakordësojnë kushtet e kontratës me Bechtel-in brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i negociatave në përputhje me këtë pikë ose një periudhë më të gjatë të dakordësuar bashkërisht nga Bechtel-i dhe ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë. Në rast se palët nuk mund të finalizojnë kontratën e fazës së parë brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë ose afatit të zgatur me dakordësinë e përbashkët, negociatat për kontratën do të



konsiderohen të mbyllura, pa asnjë kosto të shkaktuar ndërmjet palëve.

4. Procedura e negocimit për fazën e dytë të kontratës zhvillohet nga Komisioni i Negocimit, i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me përfaqësues të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë dhe ministrive të tjera të linjës ose organeve të tjera sipas përcaktimit në këtë vendim. Vendimi i Këshillit të Ministrave miraton krijimin e Komisionit të Negocimit gjatë ekzekutimit të kontratës së fazës së parë, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të propozimit zyrtar të *Bechtel*-it për kontratën e fazës së dytë pranë Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, propozim ky i cili përfshin programin dhe kalendarin e punëve, si dhe kushtet tregtare të kontratës. Komisioni i Negocimit fillon punën menjëherë pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e tij, i cili përcakton anëtarësinë e Komisionit të Negocimit, kompetencat, objektin e punës dhe procedurën e vendimmarrjes.

5. Komisioni i Negocimit negocion dhe dakordëson kushtet e kontratës me *Bechtel*-in për fazën e dytë lidhur me projektimin e ndërtimit e hidrocentralit të Skavicës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga krijimi i tij, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, ose brenda një afati më të gjatë të dakordësuar bashkërisht nga *Bechtel*-i dhe ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë.

6. Anëtarët e Komisionit të Negocimit sigurojnë të gjitha pëlqimet dhe miratimet e brendshme nga ministrinë e strukturat përkatëse përpara se drafti përfundimtar i negociuar i kontratës për projektim e ndërtim dhe raporti i negociatave t'i paraqitet autoritetit kontraktues për nënshkrim. Në rast se palët nuk mund të finalizojnë kontratën brenda periudhës së përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose brenda periudhës së zgjatur me dakordësinë e përbashkët, Komisioni i Negocimit përgatit dhe paraqet pranë autoritetit kontraktues dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë procesverbalin për ecurinë e negociatave dhe përfundimin e tyre.

7. Komisioni i Negocimit të kontratës mund të asistohet nga një konsulent i përzgjedhur nga Avokatura e Shtetit, sipas procedurave të

përcaktuara për këtë qëllim për Avokaturën e Shtetit.

Neni 4

Nënshkrimi dhe miratimi i kontratës

1. Autoriteti kontraktues dhe *Bechtel*-i nënshkruajnë kontratën e fazës së parë brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e finalizimit të kushteve të saj. Kontrata e fazës së dytë nënshkruhet nga autoriteti kontraktues brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e finalizimit të kushteve të saj nga Komisioni i Negocimit.

2. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave kontratën e nënshkruar lidhur me fazën e parë të projektit brenda 3 (tri) ditësh pune nga nënshkrimi i saj. Data e hyrjes në fuqi të kontratës për fazën e parë të projektit është data e hyrjes në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton kontratën.

3. Në rastin e kontratës për fazën e dytë të projektit, ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë përgatit dhe dërgon në Këshillin e Ministrave projektligjin për miratimin e kontratës brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga nënshkrimi i saj, në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Kontrata për fazën e dytë të projektit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të miratuar nga Kuvendi.

Neni 5

Realizimi i projektit

1. Zbatimi i kontratës për fazën e parë të projektit fillon menjëherë pas hyrjes në fuqi, në përputhje me nenin 4, të këtij ligji. Kjo kontratë përcakton shërbimet e detajuara që kryen *Bechtel*-i gjatë fazës së parë. Produktet e fazës së parë, sipas pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe energjinë.

2. Kontrata e fazës së dytë për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës zbatohet në përputhje me kushtet e saj menjëherë pas hyrjes në fuqi së saj në përputhje me nenin 4 të këtij ligji.

3. *Bechtel*-i mund të caktojë një nga filialet e tij për të nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktues, me miratimin e këtij të fundit. Një



“filial”, sipas kësaj pike, ka kuptimin e një shoqërie nën kontrollin direkt ose indirekt të *Bechtel*-it.

4. Pas miratimit të kontratës me *Bechtel*-in për projektimin dhe ndërtimin e HEC-it të Skavicës, ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe energjinë krijon një njësi të veçantë për zbatimin e këtij projekti. Ministri cakton kryetar dhe anëtarë të njësisë së zbatimit të projektit ekspertë inxhinierë, juristë dhe ekonomistë, që ndjekin zbatimin e kontratës së bashku me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare. Paga e kryetarit dhe e anëtarëve caktohet nga ministri, duke marrë për bazë pagën e drejtuesve të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 23.3.2021.

LIGJ
Nr. 39/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
“PËR NDRYSHIMIN DHE
RIVENDOSJEN E MARRËVESHJES NR.
1, NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E
BASHKËPUNIMIT TË DATËS 11 JANAR
2016 NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL, MINISTRIA E
FINANCË DHE EKONOMISË,
MINISTRIA E TURIZMIT DHE
MJEDISIT, DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
LEHTËSIMIN E MBËSHTETJES SË
AGROBIZNESIT DHE SEKTORIT TË
TURIZMIT, BERZH – SHQIPËRI,
LLOGARI BASHKËPUNIMI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr. 1, në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH – Shqipëri, llogari bashkëpunimi”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 23.3.2021.

**NDRYSHIMI DHE RIVENDOSJA E
MARRËVESHJES NR. 1,
NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E
BASHKËPUNIMIT TË DATËS 11 JANAR
2016 NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA**

i) MINISTRIA E BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË,

ii) MINISTRIA E FINANCË DHE
EKONOMISË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

iii) MINISTRIA E TURIZMIT DHE
MJEDISIT E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë [_____]



**NDRYSHIMI DHE RIVENDOSJA
E MARRËVESHJES NË LIDHJE ME
MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT,
DATË 11 JANAR 2016**

Ky ndryshim dhe rivendosje e marrëveshjes (Marrëveshja), datë [_____] është bërë nga dhe ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga:

- i. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Shqipërisë (Ministria e Bujqësisë);
- ii. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë (Ministria e Financave);
- iii. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Republikës së Shqipërisë (Ministria e Turizmit dhe së bashku me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Financave, “Ministritë”); dhe

2. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një organizëm ndërkombëtar i formuar me traktat (BERZH),

(secila “Pala” dhe së bashku “Palët”).

Duke pasur parasysh se:

A. BERZH-i ka themeluar lehtësimin e mbështetjes për agrobiznesin (Lehtësimin) për të siguruar linja kredie dhe pjesëmarrje të pafinancuar në ndarjen e rrezikut mbi bazën e portofolit për bankat dhe institucionet mikrofinanciare në Republikën e Shqipërisë për kreditimin e agrobizneseve lokale;

B. Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave dhe BERZH-i kanë hyrë në një Marrëveshje Bashkëpunimi më 11 janar 2016, për të rregulluar krijimin dhe administrimin e një llogarie në lidhje me Lehtësimin (Marrëveshja Originale);

C. Ministritë dhe BERZH-i kanë rënë dakord të përfshijnë sektorin e turizmit dhe stimujt financiarë në Lehtësimin, duke ndryshuar dhe rivendosur Marrëveshjen Originale, siç përcaktohet në, dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje;

D. Ministritë dhe BERZH-i kanë rënë dakord që Ministria e Turizmit të bëhet palë e kësaj Marrëveshje Ndryshuese për të gjitha qëllimet e saj.

Si rrjedhojë, duke marrë parasysh sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Përkufizime dhe interpretimi

a) Në këtë Marrëveshje Ndryshuese:

“Marrëveshje ndryshuese” Marrëveshja Originale, siç është rivendosur nga kjo Marrëveshje.

“Lehtësim”, lehtësimi i mbështetjes për agrobiznesin dhe turizmin shqiptar.

“Marrëveshje Originale” ka kuptimin e dhënë në pikën B.

Seksioni 2. Ndryshimi dhe vazhdimësia

Me efekt nga data në të cilën Pala e fundit nënshkruan këtë Marrëveshje, Marrëveshja Originale do të ndryshohet, siç përcaktohet në shtojcën 1 dhe rivendoset në tërësinë e saj, dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Ndryshuese.

Seksioni 3. Të ndryshme

a) Të gjitha referencat e Marrëveshjes Originale në të gjitha instrumentet dhe marrëveshjet e ekzekutuara prej saj do të interpretohen si referenca në Marrëveshjen Ndryshuese.

b) Kjo Marrëveshje do të lidhë dhe do të ndikojë në përfitimin e pasardhësve dhe caktimeve përkatëse të Palëve; me kusht që asnjë Palë nuk mund të caktojë ose transferojë ndryshe të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave ose detyrimeve të saj, sipas kësaj Marrëveshjeje pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.

c) Përveç siç parashikohet në paragrafin “b” më lart, asnjë nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk synohen të zbatohet nga ndonjë palë e tretë.

d) Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet sipas numrit të përfaqësuesve, secili prej të cilëve pasi të nënshkruhet do të ketë një kopje origjinale, së bashku do të përbëjnë një Marrëveshje.

Seksioni 4. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të një mosmarrëveshjeje që mund të lindë midis BERZH-it dhe ndonjë prej Palëve të tjera në lidhje me çdo çështje që del nga kjo Marrëveshje ose në lidhje me të, dhe një mosmarrëveshje e tillë nuk mund të zgjidhet miqësisht nga konsultimi midis Palëve, mosmarrëveshja e tillë do të zgjidhet midis Presidentit të BERZH-it dhe Guvernatorit të Republikës së Shqipërisë në BERZH.

Seksioni 5. Privilegjet dhe imunitetet e BERZH-it

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si heqje dorë, mospranim ose modifikim tjetër i çdo imuniteti, privilegji ose përjashtimi të BERZH-it të akorduar në bazë të Marrëveshjes së Themelimit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, konventës ndërkombëtare ose ndonjë ligji në fuqi.



Në dëshmi të kësaj, Banka, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, secila duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të saj, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në emrat e tyre përkatës në anglisht, në 4 (katër) kopje origjinale, së bashku me 4 (katër) kopje origjinale në shqip. Në rast mospërputhje ose paqartësie midis versionit në gjuhën angleze të marrëveshjes dhe versionit në gjuhën shqipe, versioni anglisht do të mbizotërojë.

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:	Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:
Emri:	Emri:
Pozicioni:	Pozicioni:
Data:	Data:
Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:	Për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim:
Emri:	Emri: Camilla Otto
Pozicioni:	Pozicioni: Drejtor, Bashkëfinancimi i Donatorëve
Data:	Data:

SHTOJCË 1

**MARRËVESHJA E NDRYSHUAR
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, MINISTRIA E FINANCave
DHE EKONOMISË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË
LIDHJE ME BERZH – SHQIPËRI,
LEHTËSI PËR MBËSHTETJEN E
AGROBIZNESIT DHE TURIZMIT
SHQIPTAR
LLOGARI BASHKËPUNIMI**

Kjo marrëveshje (Marrëveshja) është bërë ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga:

i. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë (“Ministria e Bujqësisë”);

ii. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Republikës së Shqipërisë (“Ministria e Turizmit” dhe së bashku me Ministrinë e Bujqësisë “Ministritë”); dhe

iii. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë (“Ministria e Financave”); dhe

2. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka” apo “BERZH”) (në tekst secili referuar si “Palë” dhe së bashku si “Palët”), në lidhje me BERZH – Shqipëri, Lehtësi Mbështetje Agrobiznesi dhe Turizmi - Llogari Bashkëpunimi (Llogaria).

DUKE PASUR PARASYSH SE:

A. Banka është e autorizuar, sipas nenit 20 të Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për të lidhur marrëveshje të bashkëpunimit me ndonjë njësi publike ose private;

B. Ministria e Bujqësisë është e autorizuar të përfundojë këtë Marrëveshje, në lidhje me mbështetje për aktivitetet e bashkëpunimit të zhvillimit, të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe funksionet e Bankës;

C. Ministria e Turizmit është e autorizuar të përfundojë këtë Marrëveshje, në lidhje me mbështetje për aktivitetet e bashkëpunimit, të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe funksionet e Bankës;

D. Ministria e Financave është e autorizuar të përfundojë këtë Marrëveshje, në lidhje me implikimet financiare për Republikën e Shqipërisë;

E. Banka ka zhvilluar një Lehtësim për Mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit në Shqipëri, një kuadër financues, sipas të cilit BERZH-i do të sigurojë linja kredie dhe pjesëmarrje të pafinancuar për ndarjen e rrezikut mbi bazë portofoli për bankat dhe institucionet mikrofinanciare në Republikën e Shqipërisë për huadhënien ndaj klientëve në sektorin e agrobizneseve dhe turizmit lokal, siç përshkruhet në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje (Lehtësimi).

F. Ministritë dëshirojnë të vënë në dispozicion të Bankës fonde të bashkëpunimit që do të përdoren për financimin e veprimtarive që do të kryhen nga Banka, me qëllim të zbatimit të



Lehtësimit, duke përfshirë dhe pagesa stimuluese për kreditë e agrobiznesit. BERZH-i ka rënë dakord për të menaxhuar dhe për të administruar fondet e bashkëpunimit të vëna në dispozicion të saj nga Ministritë, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Si rrjedhojë Palët bien dakord si më poshtë:

I. KRIJIMI I LLOGARISË

Neni 1 Llogaria

Palët kanë krijuar BERZH–BERZH–Shqipëri, Lehtësi për mbështetjen e agrobiznesit shqiptar–Llogari bashkëpunimi më 11 janar 2016 (Llogaria). Llogaria tani njihet si “BERZH–BERZH–Shqipëri, Lehtësi për Mbështetjen E Agrobiznesit dhe turizmit shqiptar - Llogari bashkëpunimi”.

II. BURIMET

Neni 2 Shuma e vënë në dispozicion nga Ministritë për Bankën

Ministritë duhet t'i vendosin në dispozicion fondit të bashkëpunimit të BERZH-it në shumën prej 36.000.000 eurosh (tridhjetë e gjashtë milionë euro) në baza jo të rimbursueshme, përveç sa parashikohet në nenin 18.2(c) të kësaj Marrëveshjeje. Ministria e Bujqësisë duhet të vendosë në dispozicion deri në 30.000.000 euro (tridhjetë milionë euro) dhe Ministria e Turizmit duhet të vendosë në dispozicion deri në 6.000.000 euro (gjashtë milionë euro).

Neni 3 Burimet

Fondet e bashkëpunimit që menaxhohen dhe administrohen nga BERZH-i, në zbatim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje (Burimet) do të përbëhen nga:

a) fondet e bashkëpunimit të vëna në dispozicion të BERZH-it, në përputhje me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;

b) plotësimet vihen në dispozicion të BERZH-it, në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje;

c) çdo e ardhur e realizuara nga investimi, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, të fondeve në llogari; dhe

d) çdo fond që mbulohet nga Banka në përputhje me nenin 9.3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 Përdorimi i burimeve

4.1 Burimet do të përdoren për të financuar:

a) marrëveshjet për ndarjen e riskut, në formën e mbulimit të parë të rrezikut të humbjes, siç përshkruhet në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) stimuj për investime për hua të përfituara vetëm nga sektori i agrobiznesit¹, siç përshkruhet në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje; dhe

c) aktivitete të tjera të tilla që mund të bihet dakord herë pas here me shkrim ndërmjet Palëve (secila e përmendur më lart “Aktiviteti”).

4.2 Burimet do të përdoren edhe për të paguar shpenzimet e kthimit, në përputhje me nenin 9.3 (nëse ka) dhe tarifës administrative në përputhje me nenin 4.3 më poshtë.

4.3 Banka ka të drejtë të zbresë dhe të mbajë një tarifë administrative të barabartë me 1% të shumës së fondeve të bashkëpunimit të vëna në dispozicion, në përputhje me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe Plotësimit, në lidhje me kostot e menaxhimit dhe administrimit të Burimeve. Një tarifë e tillë administrative do të zbritet nga fondet e bashkëpunimit pas marrjes së tyre nga Banka në Llogarinë Bankare.

Banka ka të drejtë të rregullojë shumën e taksës administrative që do të ngarkohet, në përputhje me rishikimet e ardhshme të politikave dhe të procedurave të Bankës mbi tarifat e donatorëve. Banka duhet të informojë me shkrim Ministritë për shumën e tarifës së zbatuar të taksës administrative sa më shpejt të jetë e mundur pas rishikimeve të tilla nëse ka.

Neni 5 Plotësimi

Ministritë mund, në çdo kohë, me pëlqimin e Bankës, të vendosin në dispozicion të Bankës dhe

¹ Stimuj për investime për kredi që përfitohen nga sektori i turizmit pritet të financohen përmes një instrumenti të veçantë jashtë kësaj Marrëveshjeje.



të paguajnë në Llogarinë, shumën/at e, përveç shumës së vënë në dispozicion në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje (“Plotësim/e”). Çdo plotësim do të bihet dakord me shkrim dhe do të formojë një pjesë të burimeve dhe do të rregullohen nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje, siç mund të ndryshohet herë pas here nga Palët, në përputhje me nenin 19 të këtij akti.

Neni 6

Kushtet e pagesës

6.1 Ministritë do të paguajnë fondet e bashkëpunimit që ata i vendosin në dispozicion të Bankës, në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje në të holla, në tri këste në llogarinë si vijon:

a) Ministria e Bujqësisë ka paguar shumën prej 15,476,578.48 eurosh (pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë euro e dyzet e tetë cent) ndërmjet 16 qershorit 2016 dhe 27 dhjetorit 2018;

b) Ministritë do të paguajnë 6,523,421.52 euro (gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e njëzet e një euro e pesëdhjetë e dy cent) të kontribuara me këste, sipas kërkesës së Bankës për zbatimin e Lehtësisë nga 1 janari 2021;

c) 14,000,000 euro (katërmëdhjetë milionë euro) në një datë të mëvonshme, siç do të dakordësohet me Bankën dhe Ministritë për të mbështetur nivelin më të lartë të Lehtësisë bazuar në shkallën e përdorimit dhe performancën e Lehtësisë.

6.2 Fondet e bashkëpunimit të vëna në dispozicion të Bankës, në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose plotësim/e, të marra në çdo monedhë tjetër veç euros, do të kthehen pas marrjes nga Banka në euro dhe shuma totale e euro e konvertuar kështu do të konsiderohet të jetë shuma e vënë në dispozicion dhe në Llogarinë nga Ministritë.

6.3 Të gjitha pagesat në llogari do të bëhen pas paraqitjes së kërkesës për pagesë nga Banka për Ministritë.

Neni 7

Ndarja e burimeve

7.1 Burimet duhet të mbahen të ndara nga burimet e kapitalit të zakonshëm dhe nga çdo burim fondesh të veçanta të Bankës, siç janë

përcaktuar apo të referuara në termat e Marrëveshjes themeluese të Bankës.

7.2 Në asnjë rrethanë burimet nuk do shënohen në llogari ose do të përdoren për shlyerjen e humbjeve apo të detyrimeve që rrjedhin nga operacionet ose aktivitetet e tjera të Bankës për të cilat Burimet nuk ishin kryer apo miratuar fillimisht.

7.3 Në asnjë rrethanë burimet e zakonshme kapitalit të bankës ose burimet fondeve të veçanta të Bankës do të ngarkohen me, ose të përdoren për shlyerjen e humbjeve apo detyrimeve që rrjedhin nga operacionet ose aktivitetet e tjera për të cilat burimet janë përdorur apo miratuar.

III. QEVERISJA

Neni 8

Përdorimi i Burimeve

8.1 Kur lindin rrethana që ndikojnë ndjeshëm në zbatimin, përshkrimin dhe/ose të buxhetit të çdo aktiviteti të miratuar, Banka do të informojë pa vonesë Ministritë për rrethana të tilla dhe Palët do të diskutojnë veprimet e duhura që duhet të ndërmerren, me qëllim të adresimit të rrethanave të reja.

Neni 9

Administrimi i Burimeve

9.1 Banka do të jetë përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e Burimeve, në përputhje me dhe në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Banka do të ushtrojë të njëjtin kujdes dhe përkushtim në kryerjen e funksioneve të saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, në lidhje dhe me administrimin dhe menaxhimin e fondeve të saj të tjera të bashkëpunimit.

9.2 Banka mund të miratojë procedura të tilla të brendshme, në përputhje me këtë Marrëveshje, nëse mund të konsiderohet e nevojshme ose e përshtatshme për një administrim efikas të burimeve.

9.3 Në rast të keqpërdorimit apo keqpërdorimit të dyshuar të ndonjë pjese të Burimeve nga ndonjë palë e tretë, për të cilat shuma të tilla janë paguar nga Banka, Banka, në përputhje me politikat dhe procedurat e saj përkatëse, mund të ndërmarrë procedurën e kthimit. Çdo pjesë e Burimeve, e kthyer do të kreditohet përsëri në llogari dhe do të



përdoren për qëllimet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje. Kostoja e procedurave të tilla do t'i ngarkohet Llogarisë. Në rast të fondeve të pamjaftueshme në llogarinë për të mbuluar këto shpenzime, Banka do të konsultohet me Ministrinë nëse do të fillojë ose të vazhdojë procedurën e kthimit, në varësi të konfirmimit të Ministrive se kostot e shkaktuara do të mbulohen veçmas prej tij.

IV. VEPRIMET E LLOGARISË

Neni 10 Prokurimi

Përveç rasteve kur Banka dhe Ministrinë bien dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, shërbimeve dhe/ose punëve, të nevojshme për zbatimin e çdo veprimtarie, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe që financohet nga Burimet, si dhe administrimin dhe/ose zbatimin e ndonjë dispozite të një marrëveshjeje lidhur midis Bankës dhe palëve të treta, në lidhje me menaxhimin dhe/ose administrimin e Burimeve dhe/ose Aktiviteti, do të kryhet në përputhje me politikat dhe procedurat e zbatueshme të Bankës, duke përfshirë por pa u kufizuar nga Politikat e dhe Rregullat e Prokurimit të Bankës (PP & R).

Neni 11 Llogaria Bankare

Banka do të hapë dhe do të mirëmbajë një llogari të veçantë me interes bankar në euro për t'u njohur si BERZH-Shqipëri, Lehtësi për Mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit Shqiptar Llogari Bashkëpunimi (Llogaria Bankare), në të cilën fondet e vëna në dispozicion të Bankës, në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe Plotësimi/et, nëse ka, do të paguhet nga Ministrinë.

Neni 12 Investimi dhe këmbimi valutor

12.1 Banka mund të investojë dhe të riinvestojë në varësi të disbursimeve të tyre aktuale. Të ardhurat nga një investim i tillë i Burimeve do të kreditohet në llogari dhe do të jetë në dispozicion për përdorim, në përputhje me këtë Marrëveshje. Të gjitha shumat në lidhje me mirëmbajtjen e

llogarisë bankare, duke përfshirë detyrimet bankare dhe interesin negativ, do të zbriten nga llogaria.

12.2 Banka mund të shkëmbejë lirisht Burimet në monedha të tjera, siç mund të lehtësojë përdorimin e tyre, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Banka nuk do të jetë përgjegjëse për Ministrinë, në lidhje me ndonjë humbje valutore për këtë.

Neni 13 Llogaritë dhe auditi

Banka duhet të mbajë llogari dhe të dhëna të ndara në lidhje me Burimet për të gjithë kohëzgjatjen e Llogarisë dhe çështje të tilla, si regjistra dhe llogari që do të auditohen nga auditorë të jashtëm të Bankës, në fund të çdo viti financiar të Bankës.

Neni 14 Transparenca

Banka do të sigurojë që Ministrinë të jenë të informuara në lidhje me Aktivitetin e financiar me Burimet në mënyrën e duhur.

Neni 15 Kërkesat për raportim

Banka duhet t'i raportojë Ministrive për përdorimin e Burimeve dhe zbatimin e Aktivitetit, financiar me Burimet si më poshtë:

i. një raport progresi vjetor, përgatitur në përputhje me procedurat e BERZH-it, duke detajuar aktivitetet e ndërmarra, duke theksuar progresin e arritur në lidhje me Aktivitetin, problemet dhe kufizimet e hasura, nëse ka, masa përmirësuese të marra dhe çfarëdo informacioni tjetër i rëndësishëm.

ii. një kopje të pasqyrave financiare të kontrolluara nga auditorë të jashtëm të Bankës, brenda 6 (gjashtë) muajve pas përfundimit të çdo viti financiar të Bankës.

iii. një raport financiar përfundimtar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e llogarisë; dhe

iv. një raport përfundimtar, brenda 6 (gjashtë) muajve të përfundimit të çdo Aktiviteti, duke e përshkruar rezultatin e Aktivitetit të financiar me Burime.



Neni 16 Detyrim

Banka nuk do të ketë detyrime të tjera ndaj Ministrive, përveç menaxhimit dhe administrimit të Burimeve, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

V. HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI

Neni 17 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në mënyrë të përkohshme që nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe do të hyjë në fuqi përfundimisht në momentin që Banka të marrë njoftimin me shkrim nga Ministria e Bujqësisë, e cila konfirmon se të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi janë përfunduar nga Ministritë dhe Ministria e Financave.

Neni 18 Përfundimi

18.1 Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e zbatimit ose ndërprerjes nga Banka, Lehtësimet e Burimeve janë shfrytëzuar plotësisht, cilado që ndodh më herët, nëse nuk prishet nga secila prej Palëve me paraqitjen e njoftimit me shkrim gjashtëmujor të Pala tjetër, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni 18, si më poshtë.

18.2 Pas marrjes së njoftimit të përfundimit nga secila palë në përputhje me paragrafin 18.1 më sipër, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Banka do të ndërpresë menjëherë të gjitha aktivitetet që lidhen me Burimet, përveç atyre të rastësishme për realizimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre Burimeve dhe shlyerjen e detyrimeve të drejtpërdrejta ose të kushtëzuara, të cilat këto burime mund të jenë subjekt;

b) çdo marrëveshje tashmë e lidhur ndërmjet Bankës dhe një pale të tretë, me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të ndikohet nga njoftimi për ndërprerjen dhe Banka ka të drejtë të vazhdojë tërheqje nga llogaria, në lidhje me marrëveshje të tilla deri në përfundimin e tyre;

c) nëse nuk është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve, shuma e mbetur në Llogarinë pasi të gjitha

detyrimet janë shlyer (përfshirë taksën administrative borxh për Bankën), do t'i kthehen Ministrive. Kthimi i tillë do t'i nënshtrohet zgjidhjes paraprake të të gjitha pretendimeve dhe të ankesave nga ana e Bankës kundrejt Ministrive në lidhje me këtë Marrëveshje;

d) përveç siç është përcaktuar në këtë nen 18.2 të Marrëveshjes, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të vazhdojnë të pacenuara deri në kthimin e shumës sipas nenit 18.2(c) për Ministritë dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit, sipas nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje, dhe në këtë kohë kjo Marrëveshje përfundon.

18.3 Nenet 18.2(c) dhe 18.2(d) këtu më sipër do të zbatohen edhe pas përfundimit të zbatimit, apo ndërprerjes nga Banka, të Lehtësimet.

18.4 Nenet 16, 21 dhe 22 të kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme deri në përfundim të saj.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19 Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim nga Palët Nënshkruese.

Neni 20 Përparësitë

Në rast të ndonjë mospërputhje apo kundërshtim ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe në aneksin I, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë.

Neni 21 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeje

Nëse lindin mosmarrëveshje midis Bankës dhe Ministrive, lidhur me çfarëdo çështje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve, mosmarrëveshje të tilla do të zgjidhen ndërmjet Presidentit të Bankës dhe Guvernatorit të Republikës së Shqipërisë për Bankën.



Neni 22

Të drejtat, imunitetet dhe përjashtimet

Asgjë në këtë Marrëveshje, nuk do të konsiderohet të jetë heqje dorë, e shprehur apo e nënkuptuar, nga privilegjet, imunitetet dhe përjashtimet që gëzon (ka) Banka, Guvernatorët e saj, drejtorët, zëvendësit, nëpunësit, punonjësit apo ekspertët që kryejnë misionet për Bankën.

Neni 23

Komunikimet

Çdo njoftim dhe komunikim i dhënë ose bërë sipas kësaj Marrëveshjeje për palët, do të jetë me shkrim dhe do të dërgohet në adresën dhe numrin e faksit në vijim (vetëm nëse një Palë mund t'ia ketë specifikuar ndryshe me shkrim, Palës tjetër):

Për Ministrinë e Bujqësisë:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Shqipërisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, KP 1001, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: +355 4 22 27 916

Për Ministrinë e Financave:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, KP 1001, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: +355 4 223 0803

Për Ministrinë e Turizmit:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Republikës së Shqipërisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, KP 1001, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: +355 4 222 4537

Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Drejtorit, Bashkëfinancimi i Donatorëve

Tel.: +44 20 7338 7266

Fax: +44 20 7338 6538

Faqe | 6206

Në dëshmi të kësaj, Banka, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Turizmit dhe Ministria e Financave, secila duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze, në 4 (katër) kopje origjinale në secilën gjuhë.

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

Emri:

Pozicioni:

Data:

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

Emri:

Pozicioni:

Data:

Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

Emri:

Pozicioni:

Data:

Për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim:

Emri: Camilla Otto

Pozicioni: Drejtor, Bashkëfinancimi i Donatorëve

Data:

ANEKSI I**I. Përshkrimi i Lehtësimit**

Lehtësimi për Mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit Shqiptar (Lehtësimi) është një kuadër financimi i hartuar nga BERZH-i në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i cili synon të përmirësojë aksesin për financim për agrobiznesin shqiptar dhe sektorin e turizmit nëpërmjet bankave komerciale dhe institucioneve jobankare mikrofinanciare (bashkërisht të referuara si “Institucionet Financiare Pjesëmarrëse” ose “IFP”). Të gjitha IFP-të që operojnë në Shqipëri kanë të drejtë për t'u bashkuar me Shërbimin e Lehtësimit, në bazë të respektimit të standardeve kreditore dhe integritetit të BERZH-it.

Ritmi i IFP-ve së bashku me Lehtësimin do të varet, ndër të tjera nga disponueshmëria e fondeve të bashkëpunimit të vëna në dispozicion nga Ministritë për Bankën, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, në çdo kohë të caktuar.

BERZH-i parashikon vënien në dispozicion deri në 100 milionë euro, e cila pritet të mbështesë



angazhimin deri në 180 milionë euro të nivelit total të huas, nga të cilat deri në 30 milionë euro në mbështetje të financimit të sektorit të turizmit. BERZH-i do të vendosë në dispozicion mbulimin e rrezikut të humbjes së parë (FLRC), nëse dhe në masën që ka marrë kontribute nga Ministrinë, siç përcaktohet në nenet 2 dhe 6 të Marrëveshjes, si dhe në vijim.

Në përputhje me nenin 2 të Marrëveshjes, shuma e vënë në dispozicion nga Ministria e Bujqësisë do të përdoret për mbulimin e rrezikut të humbjes së parë FLRC dhe dhënien e stimuljeve të investimeve për sektorin e agrobiznesit dhe shuma e vënë në dispozicion nga Ministria e Turizmit do të jetë për mbulimin e rrezikut të humbjes së parë FLRC për sektorin e turizmit.

Lehtësimi do të përbëhet nga:

1. Linja Kredie për Agrobiznesin dhe Turizmin – linja kredie të pasiguruar që do t'u ofrohen institucionet financiare pjesëmarrëse (IFP) për huadhënie ndaj subjekteve të agrobiznesit dhe turizmit. IFP-të do të ketë mundësi të marrin hua në monedhën vendëse. Linjat e kredisë pritet të kenë një kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

2. Lehtësimi i Agrobiznesit dhe Turizmit për Ndarjen e Riskut - një pjesëmarrje e pafinancuar në një portofol bazuar në instrumentin e ndarjes së riskut, që mbulon deri në 50% të shumës totale të një portofoli të kredive të papaguara të pranueshme të agrobiznesit dhe turizmit, në përputhje me një grup të paracaktuar të kriterëve të kualifikimit (përshtatshmërisë) (Nënua). Sipas kësaj strukture, Nënua do të gjenerohet, vlerësohet, miratohet, disbursohet dhe monitorohet nga çdo IFP, në përputhje me politikat e tyre të kreditimit. Përmes Lehtësisë BERZH-it do të mbulojë deri në 50% të riskut të portofolit të Nënhuasë, duke ndarë mbi baza të paracaktuara proporcionale me IFP-në për çdo humbje të shkaktuar nga një portofol i tillë, si dhe çdo rikuperim të mundshëm nga Nënua e papaguara.

Çdo Lehtësim për Ndarje të Riskut për Agrobiznesin dhe Turizmin do të jetë një strukturë e hapur që do të fillojë me një gjendje/stok deri në 50% të portofolit të kredisë ekzistuese të agrobiznesit të një IFP-je të caktuar, që përputhet me kriteret e përshtatshmërisë (Gjendja Fillestare). IFP-të do të angazhohen për të sjellë Nënua të përshtatshme për sektorin e agrobiznesit dhe të

turizmit që arrin të paktën dy herë shumën e Gjendjes Fillestare (një portofol maksimal që do të gjenerohet, mund të bihet dakord me IFP-në rast pas rasti) mbi një periudhë deri në 5 vjet nga data kur Marrëveshja e Pjesëmarrjes në Risk ndërmjet BERZH-it dhe IFP-së bëhet efektive.

Pas këtyre 5 vjetëve të ndërtimit të portofolit, sistemi do të mbyllet dhe BERZH-i do të vazhdojë të mbulojë pjesën e tij të portofolit të papaguar të Nënhuave derisa ato të shlyhen plotësisht, deri në një datë të përfundimit të dakordësuar që nuk do të kalojë 3 vjet nga mbyllja e sistemit. Kjo strukturë do t'u mundësojë IFP-ve të rrisin portofolin e tyre të huave në sektorin e agrobiznesit dhe të turizmit në të paktën 200% (ose më shumë) të nivelit aktual deri në kohën e mbylljes së sistemit (d.m.th. deri në 5 vjet).

Për këtë pritet që zbatimi i Lehtësisë në çdo IFP do të marrë deri në 8 vjet, ndërsa kohëzgjatja e pritshme e të gjithë Lehtësimit në mbarë vendin do të jetë më e gjatë, në varësi nga data kur IFP-ja e fundit do t'i bashkohet Lehtësimit.

Këto dy komponentë – Linja kredie për agrobiznesin dhe turizmin dhe Lehtësimi për Ndarjen e Riskut – janë plotësues dhe mund të vihen në dispozicion veçmas ose bashkërisht për çdo IFP, në varësi të preferencave të tyre. Bazuar në vlerësimet paraprake në konsultimet me disa IFP potenciale, është vlerësuar se shuma e përgjithshme e Nënhuas së portofolit të mobilizohet nëpërmjet Lehtësimit në fazën e parë, e cila do të jetë rreth 180 milionë euro (shuma e saktë do të varet nga përqindja e stimulit të investimeve të agrobiznesit si dhe pjesës së Linjave të Kredive për Agrobiznesin dhe Turizmin kundrejt Lehtësimit për Ndarjen e Riskut të Agrobiznesit dhe Turizmit për të cilat këto IFP do të abonohen).

- Lehtësimi do të përfitojë nga tre komponentë shtesë:

- Mbulimi i Riskut për Humbjen e Parë (FLRC) mbulon:

- në rastin e Linjave të Kredisë të Agrobiznesit dhe Turizmit – humbjet deri në 20% të shumës totale të Nënhuave të financuara me vazhdimin e Linjave të Kredisë së Agrobiznesit dhe Turizmit;

- në rastin e Lehtësimi për Ndarjen e Riskut të Agrobiznesit dhe Turizmit - humbjet deri në 20% të portofolit të Nënhuave të pranueshme ndahen midis BERZH-it dhe IFP-së. Çdo humbje shtesë



nga Nënhuat e papaguara që tejkalon mbulimin e FLRC-së do të ndahet në bazë të riskut mes BERZH-it dhe IFP-së.

Fondet për FLCR-në do të sigurohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministritë, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje. Pritet që ajo do të ndihmojë në mënyrë të konsiderueshme për të përmirësuar aksesin për financim për huamarrësit e agrobiznesit dhe turizmit, duke ulur koston e rrezikut për IFP-të nxitjes së tyre për të zgjeruar huadhënien për sektorin e agrobiznesit dhe të turizmit dhe nëpërmjet konkurrencës midis IFP-ve, të çojë në norma më të përballueshme të kreditimit për huamarrësit përfundimtarë.

- Stimuj për investime për agrobizneset që marrin pjesë në linjat e kredisë apo Lehtësinë e Ndarjes së Riskut për Agrobiznesin. Subjektet që marrin hua për investime kapitale me një matur prej të paktën 18 muajsh do të jenë të përshtatshme për të marrë një pagesë stimuluese në formën e një granti prej 10% të vlerës së huas, në varësi të verifikimit të suksesit të zbatimit të huas dhe investimit kapital nga Konsulenti Verifikues (KV). Kriteret e Nënhuas do të përcaktohen qartë dhe do të bien dakord me IFP-të që do të Nënhuat. Stimujt për investime për kreditë që përfitojnë nga sektori i turizmit pritët të financohen përmes një instrumenti të veçantë nga kjo Marrëveshjeje.

Çdo Nënhua e dhënë nën Lehtësinë para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ndryshuese nuk do të jetë e përshtatshme për të marrë stimuj investimit (pra vetëm huat e reja të lëshuara pas datës së ndryshimit të marrëveshjes/ve përkatëse të projektit me secilin IFP do të jenë të pranueshëm për stimuj për huamarrësit.

Fondet për stimuj investimesh për kredi që përfitojnë nga agrobiznesi do të vendosen në dispozicion nga Qeveria Shqiptare, përfaqësuar nga Ministritë, sipas termave të kësaj Marrëveshjeje.

- Asistenca Teknike (AT), e cila do të përbëhet nga dy komponentë:

A. Sektori i Agrobiznesit dhe Turizmit – AT specifike:


i. Vlerësimi i problemeve të mundshme të sektorit që pengojnë aksesin për financim përmes analizës së portofolit ekzistues të IFP-së së portofolit ekzistues të agrobiznesit dhe të klientëve të rinj të synuar. Kjo analizë mund të ndihmojë, gjithashtu, për të identifikuar pikat përkatëse hyrëse për dialog të mundshëm politik me Qeverinë në çështjet strukturore specifike të sektorit, duke garantuar përputhshmërinë dhe sinergjitë e mundshme ndërmjet Lehtësimit të propozuar dhe vazhdimësisë së aktiviteteve specifike të sektorit, të mbështetura nga donator të tjerë.

ii. Shërbime këshillimore ndaj huamarrësve të IFP-ve dhe huamarrësve potencialë do të sigurohet nga BERZH-i – grupi Mbështetja e Biznesit të Vogël (SBS). Mbështetja këshilluese e SBS-së për agrobizneset dhe turizmin synon të lehtësojë aksesin për njohuritë dhe hartimin e shërbimeve jofinanciare, duke mbështetur SME-të² e lejueshme në zonat që rrjedhin nga strategjitë, veprimet e menaxhimit të cilësisë specifike për sektorin e agrobiznesit dhe turizmit. Gjithashtu, vlerësimi i mësipërm do të ndihmojë për identifikimin e nevojave për hartimin e shërbimeve shtesë jofinanciare, specifike për sektorin e agrobiznesit dhe turizmit.

B. Ngritja e kapaciteteve të IFP-së: për të mbështetur kapacitetet e tyre për të siguruar dhe kërkuar kredi në bazë të Programit dhe për të promovuar këto kredi në rajon. Asistenca teknike që do të zbatohet nga një Konsulent i Projektit (KP) për të zhvilluar programin, për të ndërtuar një linjë orientuese, për të ndihmuar në aplikimet për kredi, për të zhvilluar sisteme dhe mjete për të ofruar shërbime të përshtatshme dhe të dedikuara për agrobiznesin dhe turizmin, si dhe për të marketuar Programin dhe një Konsulent Verifikimi (KV) për të verifikuar pajtueshmërinë e Nënhuave të implementuara përpara se të jepen stimujt e investimeve.

² Sipas përkufizimit të BE-së për SME-t: ndërmarrjet me 50 milionë euro xhiro vjetore ose me bilanc total më pak se 43 milionë euro dhe më pak se 250 punonjës.

Në skemën e mëposhtme jepet struktura e Lehtësimit:



II. Qeverisja

Komiteti Drejtues do të krijohet për të monitoruar zbatimin e Aktivitetit (siç është përcaktuar në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje). Ai do të përbëhet nga përfaqësues të kualifikuar nga Ministrinë dhe BERZH-i dhe do të mbledhet çdo vit, zakonisht një muaj pas marrjes së raportit vjetor të progresit. Puna e Komitetit Drejtues do të jetë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregullat, politikat dhe procedurat përkatëse të Bankës. Në rastet kur puna e Komitetit Drejtues kërkon që Banka të sigurojë ndonjë informacion, ky informacion do të sigurohet mbi baza të shëndosha dhe në përputhje me Politikën e Bankës për Informimin Publik.

Roli i Komitetit Drejtues do të jetë:

- të shqyrtojë raportin vjetor për zbatimin e veprimtarisë;
- të marrë në konsideratë përvojat e fituara gjatë zbatimit të Aktivitetit, me qëllim propozimin e përmirësimeve;
- të rishikojë arritjet e Lehtësisë në kontekstin e objektivave zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për sektorin e agrobiznesit dhe turizmit në periudhën e caktuar;
- të diskutojë dhe dakordësojë planin e vizibilitetit për të promovuar Aktivitetin;
- të rishikojë, sipas rastit, botimet, të cilat raportojnë mbi Aktivitetin.

III. Vizibiliteti

Aktivitetet e vizibilitetit do të sigurojnë shpërndarjen e informacionit, në lidhje me objektivat dhe arritjet e Aktivitetit. Aktivitetet që do të ndërmerren mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- ngjarjet lidhur me lançimet/mbylljet e programit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qeverisë Shqiptare;
- marrëdhëniet me mediet (intervista në revista/gazeta lokale të biznesit);
- ngjarje të veçanta (p.sh. seminare ndërgjegjësimi);
- studime të rastit (p.sh. artikuj që paraqesin histori suksesi për shtypin);
- internet dhe përmbajtje në internet në gjuhën lokale;
- të dhëna në mediet sociale.



LIGJ
Nr. 40/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË
ANGAZHIMIT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE, DHE ALEANCËS
GAVI, PËR PJESËMARRJEN NË
STRUKTURËN GLOBALE TË QASJES
NË VAKSINAT COVID-19 (*COVAX
FACILITY*), MIRATUAR ME LIGJIN
NR. 134/2020**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 2, dhe 121, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së angazhimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (*Covax Facility*), miratuar me ligjin nr. 134/2020, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.3.2021.

LETËR NDRYSHIMI

Nga: GAVI ALLIANCE (GAVI)
Chemin du Pommier 40,
1218 Le Grand-Saconnex
Switzerland (Zvicër)
Për: [.] (Pjesëmarrësin)
[Vendosni të dhënat e njoftimit të
Pjesëmarrësit] _____2021

I nderuar Pjesëmarrës,

Instrumenti COVAX – Letër Ndryshimi për
Marrëveshjen e Angazhimit

1. Hyrje

1.1 I referohemi Marrëveshjes së Angazhimit të datës [], [Shënim. GAVI duhet të konfirmojë datën e hyrjes në fuqi të MA-së] dhe të lidhur ndërmjet GAVI dhe Pjesëmarrësit (Marrëveshja e Angazhimit).

1.2 Përveç rasteve kur përcaktohet në këtë Letër Ndryshimi ose konteksti e kërkon ndryshe, një term i përcaktuar në Marrëveshjen e Angazhimit ka të njëjtin kuptim në këtë Letër Ndryshimi dhe Referencat e Klauzolës në këtë Letër Ndryshimi janë referenca ndaj Klauzolave të Marrëveshjes së Angazhimit.

1.3 Klauzolat 1.2 (Ndërtimi), 1.3 (Njëjësi, shumësi, gjinia), 1.4 (Klauzolat), 1.5 (Efekti jokufizues i fjalëve) dhe 1.6 (Përparësia) e Marrëveshjes së Angazhimit do të zbatohen siç përcaktohet plotësisht në këtë Letër Ndryshimi dhe sikur të gjitha referencat në ato klauzola ndaj të “kësaj Marrëveshjeje” të ishin një referencë e këtij Letre Ndryshimi.

2. Ndryshime/Amendime

2.1 Duke hyrë në fuqi nga data e siglimit të kësaj Letre Ndryshimi nga Pjesëmarrësi, Marrëveshja e Angazhimit do të ndryshohet, në përputhje me klauzolën 14.4 (Ndryshimet dhe heqjet dorë) të Marrëveshjes së Angazhimit, si më poshtë:

2.1.1 Në klauzolën 1.1 (b) (Përkufizimet) e Marrëveshjes së Angazhimit dhe shtojcën 1 (Fjalorthi i Termave) të Termave dhe Kushteve, përkufizimi i Vaksinës së Miratuar do të ndryshohet si më poshtë:

“Vaksinë e Miratuar” nënkupton një vaksinë kundër COVID-19, në lidhje me të cilën GAVI ka



ndërmarrë një Angazhim të Përparuar të Blerjes dhe që ka ose Parakualifikim të OBSH-së, autorizim standard/të kushtëzuar marketingu ose një autorizim për përdorim emergjent të vendosur nga një SRA ose Autorizim Përdorimi Emergjent të OBSH-së.

2.1.2 Në paragrafin 11 (Angazhimi me prodhuesit) i Termave dhe Kushteve, paragrafi i dytë nën titullin “Angazhimet mbi volumin” do të ndryshohet si më poshtë:

“Për prokurim, vaksina duhet të jetë Vaksinë e Miratuar.”.

2.2 Palët pranojnë që paragrafi 16 i Termave dhe Kushteve (i cili nuk është detyrues për Palët në përputhje me klauzolën 12 të Marrëveshjes së Angazhimit) nuk është më i zbatueshëm.

2.3 Për të shmangur dyshimin, me anë të kësaj është rënë dakord që ndryshimet e paraqitura në këtë Letër Ndryshimi janë në interes të të dyja Palëve dhe secila Palë e pranon këtë përfitim, në konsideratë të nënshkrimit të kësaj Letre Ndryshimi.

2.4 Ndryshimet e përcaktuara në këtë Letër Ndryshimi nuk do të cenojnë të drejtat dhe detyrimet e akumuluar të një Pale, në përputhje me Marrëveshjen e Angazhimit në datën kur Letra e Ndryshimit hyn në fuqi.

3. Të ndryshme

3.1 Pjesëmarrësi përfaqëson dhe i garanton GAVI-it, se:

3.1.1 Ka fuqi dhe autoritet të plotë për të hyrë, kryer dhe dorëzuar këtë Letër Ndryshimi dhe transaksionet e parashikuara në të;

3.1.2 Kjo Letër Ndryshimi është autorizuar, ekzekutuar dhe dorëzuar prej tij, sipas rregullave dhe përbën detyrime ligjore të vlefshme e detyruese të tij dhe të zbatueshme ndaj tij, në përputhje me kushtet e tij; dhe

3.1.3 Të gjitha veprimet që duhen ndërmarrë (përfshirë marrjen e ndonjë Autorizimi) për hyrjen e tij në këtë Letër Ndryshimi, kryerjen e transaksioneve të tjera të parashikuara këtu, ose pajtueshmërinë prej tij me kushtet e vendosura këtu, sipas rastit, janë ndërmarrë dhe të gjitha autorizimet janë në fuqi dhe efekt të plotë.

3.2 Dispozitat e klauzolave 13 (Komunikimet), 14 (Të ndryshme), 15 (Ligji rregullues) dhe 16 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të Marrëveshjes së Angazhimit do të zbatohen për këtë Letër Ndryshimi, siç do të përcaktohej plotësisht në këtë

Letër Ndryshimi dhe sikur referencat në ato klauzola të “kësaj Marrëveshjeje” të ishin referenca ndaj kësaj Letre Ndryshimi dhe referencat ndaj “palës” ose “palëve” janë referenca ndaj Palëve të kësaj Letre Ndryshimi.

Faqja e nënshkrimit për Letrën e Ndryshimit

Me respekt,

ALEANCA GAVI

Emri:

Titulli:

Data:

Ne i pranojmë dhe biem dakord me kushtet e kësaj Letre Ndryshimi të përcaktuara më lart.

Pjesëmarrësi

Emri:

Titulli:

Data:

Organizata (Ministria/departamenti)

AKT NORMATIV

Nr. 19, datë 16.4.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR NDËRMJET “HUMAN VACCINE” LLC DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN TË SHQIPËRISË DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN KUNDËR COVID-19 “SPUTNIK V”, TË ZHVILLUAR NGA INSTITUTI KOMBËTAR I KËRKIMIT GAMALEYA PËR EPIDEMIOLOGJINË DHE MIKROBIOLOGJINË NË RUSI

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe



Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i marrëveshjes së nënshkruar

Miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet “*Human Vaccine*” LLC dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën “Sputnik V”, të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit *Gamaleya* për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 232, datë 14.4.2021

**PËR CAKTIMIN E MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR
REALIZIMIN E PROCEDURËS SË
PROKURIMIT ME OBJEKT
“MBROJTJEN E GËSHTENJËS NGA
PARAZITI GRERËZA GALEFORMUESE
DRYOCOSMUS KURIPHILUS
HYMENOPTERA: CYNIPIDAE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organ qendror blerës për

realizimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese (*Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae*)”.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ngarkohet për lidhjen e kontratës, objekt prokurimi, dhe monitorimin e zbatimit të kontratës.

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, monitoron respektimin e kërkesave teknike trajtuese të vendosura në zbatim të këtij procesi.

4. Fondi për procedurën e prokurimit publik të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2021, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpenzimet korrente në programin buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, produkti “Sipërfaqe e trajtuar dhe e mbrojtur nga parazitët në fushën e bujqësisë”.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR

Nr. 183/1, datë 8.4.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 633, DATË 17.11.2020,
“PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE
NË VENDE TË MBYLLURA APO
TË HAPURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, si edhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 1594/3, datë 7.4.2021,



URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit togfjalëshi “deri në datën 8.4.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 22.4.2021”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 16, datë 16.3.2021

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja	anëtare e	“	“

me sekretare Enina Kotoni, në datën 16.3.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 2 (S) 2018 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “FG Shoes” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 00-2017-1692, datë 26.9.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000); neni 6, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Shkodër dhe, pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja (ish “Calzaturificio Adelchi” sh.p.k.) është një shoqëri tregtare që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në fushën e prodhimit dhe përpunimit të këpucëve. Ajo i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Shkodër me kërkesë për të përfituar nga amnistia fiskale për faljen e gjobave dhe të kamatëvonesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, bazuar në ligjin nr. 10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” (ligji nr. 10418/2011).

2. Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT), Shkodër e ka njoftuar kërkuësen se nuk i plotëson kushtet për të përfituar nga amnistia fiskale.

3. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi me objekt “detyrimin e subjektit të interesuar DRT-së, Shkodër, të njohë faljen e gjobave dhe të kamatëvonesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që i përkasin periudhës deri në datën 31.12.2010, në shumën 17.862.006 lekë”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1249, datë 21.5.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 249, datë 16.1.2014, ka vendosur moskompetencën e saj dhe dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi, Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 801, datë 18.3.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1249, datë 21.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e padisë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1692, datë 26.9.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësja, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58, i ligjit nr. 49, datë



3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).

8. Në datën 19.1.2018 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) dhe ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2017-1692, datë 26.9.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

9. Kolegji i Gjykatës, në datën 23.5.2018, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

10. Kërkesja, shoqëria “FG Shoes” sh.p.k., ka parashtruar përpara Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, se vendimi nr. 00-2017-1692, datë 26.9.2017, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë cenon:

10.1 *Parimin e gjykimin brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60, pika 2, e ligjit nr. 49/2012.

10.2 *Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, sepse ky vendim nuk përmbush kërkesat as për një arsyetim minimal.

10.3 *Të drejtën e aksesit në gjykatë*, si dhe *të drejtën e ankimit* në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve që lidhen me shkeljen e ligjit dhe të të drejtave kushtetuese, të ngritura nga kërkesja.

11. Subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Shkodër, ka prapësuar:

11.1 Kërkesja nuk legjitimohej t’i drejtohej gjykatës për detyrimin e organit tatimor që t’i njohë faljen e gjobave dhe të kamatëvonesave, duke referuar në objektin e kërkesëpadisë një vlerë të përgjithshme detyrimi. Ajo nuk arriti të provojë përpara gjykatës se çfarë përfaqëson kjo vlerë detyrimi dhe se cilës periudhë tatimore i përket.

11.2 Sipas nenit 18 të ligjit nr. 10418/2011, kërkesja nuk është vlerësuar si përfituese e faljes për vlerat përkatëse të detyrimit.

11.3 Kërkesja është njoftuar nëpërmjet shkresës nr. 4161 prot., datë 8.6.2012, të DRT-së, Shkodër, për qëndrimin e kësaj të fundit, në lidhje me faljen e detyrimeve. Kjo shkresë i është dorëzuar kërkeses në datën 12.6.2012. Subjekti i

interesuar ka respektuar ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” për sa i përket njoftimit me shkresë.

11.4 Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

12. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars të vitit 2018, nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor të kërkuar nga neni 32, pika 1, e ligjit nr. 8577/2000, për formimin dhe funksionimin e shqyrtimit të çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

A. Për legjitimitimin e kërkeses

13. Gjykata vëren se, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, llojin e pasojave negative të pësuar, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor objekt i ankimit kushtetues individual.

15. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Shterimi i mjetit është kusht si në rastet e kundërshtimit të një vendimi gjyqësor, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.



8577/2000, të lartpërmendur, ashtu edhe në rastet e kundërshtimit të një dispozite ligjore/ligji.

16. Në çështjen konkret rezulton se vendimi i fundit që ka përmbyllur procesin gjyqësor dhe ka vendosur në mënyrë përfundimtare për pretendimet e kërkuases është vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuessa e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese.

17. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, prandaj kërkuessa legjitimohet *ratione temporis*.

18. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuessa ka pretenduar cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të së drejtës për akses në gjykatë dhe të së drejtës për ankim në aspektin substancial, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues.

19. Kërkesat për mosshqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën e Gjykatës janë trajtuar në këndvështrim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata ka vlerësuar se në bazë të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individit legjitimohet për të pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe në këtë drejtim, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 (të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017) është përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7) etj. Pra, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore efektive me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive, në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

20. Në rastin në shqyrtim procesi në Gjykatën e Lartë, objekt shqyrtimi, ka përfunduar në datën 26.09.2017, ndërsa ndryshimet në KPC kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017. Gjithashtu, konstatohet se ligji nuk ka parashikuar efekte prapavepruese për çështjet e përfunduara në datën e hyrjes së tij në fuqi. Në këtë kuptim, kërkuessa nuk ka mjet tjetër efektiv përveç kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

21. Për sa më lart, kërkuessa *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e saj hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

22. Kërkuessa pretendon se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit nga gjykata ku ai është depozituar.

23. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

24. Gjykata lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuessit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuessin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 1, datë 21.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të vlerësohet analiza e secilit prej elementeve të sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

25. Lidhur me pretendimin për zgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë tej afatit të arsyeshëm, nga materialet e administruara Gjykata vëren se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.9.2014 dhe gjykimi i saj është



bërë në datën 26.9.2017. Pra, vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë pasi kanë kaluar 3 vjet nga regjistrimi i çështjes.

ii. Komplexiteti i çështjes

26. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Komplexiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata vëren se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkueses është me rëndësi në këtë kontekst.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuetit

28. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkueses është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata çmon se kërkuessa nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.

iv. Sjellja e autoriteteve

29. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme.

30. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka vënë re se neni 3 i ligjit nr. 49/2012, ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Ligji nr. 49/2012 synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e

mosmarrëveshjeve administrative dhe se në këtë drejtim qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, ligji nr. 49/2012, ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 - për veprimet përgatitore, neni 27 - për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48, pika 2 - për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60, pika 2 - rasti në shqyrtim) (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata është shprehur se respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Po në këtë këndvështrim Gjykata në çështje të ngjashme ka vlerësuar se justifikimet se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve që kanë në ngarkim këto gjykata, nuk janë të bazuara. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 3, datë 6.12.2018; nr. 46, datë 3.7.2017; nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në këto kushte, Gjykata çmon se çështja në Gjykatën e Lartë nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi kjo e fundit ka marrë vendim për çështjen 3 vjet pas regjistrimit të saj, çka në raport me afatin ligjor 90-ditor është një kohëzgjatje e paarsyeshme. Për pasojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, është i bazuar.



B.2 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit

33. Kërkesja pretendon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, sepse vendimi i mospranimit të rekursit nuk përmbush kërkesat as për një arsyetim minimal. Gjithashtu, kërkesja pretendon se duke mos u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të saj që lidhen me shkeljen e ligjit dhe të të drejtave kushtetuese, vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial.

34. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sipas tij, ajo nuk legjitimohej t'i drejtohej gjykatës për detyrimin e organit tatimor që t'i njohë faljen e gjobave dhe kamatëvonesave, pasi, sipas ligjit, nuk është vlerësuar si përfituese e faljes për vlerat përkatëse të detyrimit.

35. Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv. Gjykata ka pohuar se në rastet kur kërkesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet

të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Ndërsa lidhur me vendimet e mospranimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata është shprehur edhe herë të tjera për rolin që ka dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, ligji nr. 49/2012 në nenin 61 ka përcaktuar se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi dhe në nenin 62 ka parashikuar se cilat janë, përjashtimisht, rastet e



shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

39. Nga ana tjetër, për sa i përket arsytimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 9, datë 26.3.2018; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe i ka dhënë përgjigje kërkueses se pretendimet e saj nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, ka ushtruar në këtë rast funksionin e saj seleksionues, duke vlerësuar paraprakisht nëse kërkesa i plotësonte kërkesat e ligjit për kalimin në seancë. Edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ajo ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e mësipërme të arsytimit në dhomën e këshillimit.

41. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsytimit, i lidhur me të drejtën për akses në gjykatë dhe të drejtën e ankimit substancial, është i pabazuar.

42. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se në rastin konkret është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjyqimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 60, pika 2, e ligjit nr. 49/2012.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.

- Konstatimin e gjykimit tej afatit ligjor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.3.2021.

Shpallur më 13.4.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

Anëtare kundër: Përparim Kalo

MENDIM PAKICE

1. Në lidhje me çështjen me kërkuese shoqërinë “FG Shoes” sh.p.k., edhe pse jam pajtuar me përfundimin e arritur dhe të vendosur nga shumica për konstatimin e tejkalimit të afatit brenda të cilit duhej gjykuar çështja nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerësoj se Gjykata duhet ta kishte pranuar tërësisht kërkesën, duke vendosur shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë edhe për shkak të pamjaftueshmërisë së arsytimit të vendimit gjyqësor, që lidhet me të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykim nga ana materiale (substanciale).

2. Nga rrethanat e kësaj çështjeje rezulton se kërkuësja i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, bazuar në ligjin nr. 10418/2011, për të përfituar faljen e gjobave dhe të kamatëvonesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga amnistia fiskale, e cila nuk i është pranuar nga organi administrativ. Për rrjedhojë, ajo i është drejtuar me padi gjykatës, me objekt detyrimin për faljen e gjobave dhe të kamatëvonesave të vendosura për shkak të mosderdhjes së kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën deri më 31.12.2010, në shumën 17.862.006 lekë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1249, datë 21.5.2013, ka vendosur pranimin e padisë, por vendimi i saj është ankimuar



nga organi tatimor dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 801, datë 18.3.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e padisë.

4. Kërkesja ka paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në Gjykatën e Lartë dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1692, datë 26.9.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke u shprehur se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

5. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, duke pretenduar se mospërmbushja e standardit të arsyetimit të vendimit i ka cenuar të drejtën kushtetuese për proces të rregullt. Kërkesja pretendon madje se vendimi nuk ka përmbushur as standardin minimal të arsyetimit, të zhvilluar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe ajo e GJEDNJ-së. Sipas saj, duke mos i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat lidhen me shkelje të ligjit dhe të të drejtave kushtetuese, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial.

6. Në lidhje me standardin e arsyetimit, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar, që garantohej nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve. Qëllimi i arsyetimit të vendimit është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe t’u japë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Nëpërmjet arsyetimit gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Pra, sipas Gjykatës, nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i paraqitur në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Midis arsyetimit dhe legjitimitetit të vendimit ekziston një lidhje e ngushtë, prandaj nëse arsyetimi mungon ose ka defekte të tilla që tejkalojnë kufijtë e logjikës juridike, kjo passjell, nga njëra anë, cenim të vetë legjitimitetit të vendimit gjyqësor dhe, nga ana tjetër, cenim të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Zbatimi i parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se e vlerëson respektimin e këtij parimi vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, ndërsa neni 43 i saj parashikon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë dhe neni 142, pika 1, përcakton detyrimin e organeve gjyqësore që t’i arsyetojnë vendimet gjyqësore. Nga interpretimi në tërësi i këtyre dispozitave kuptohet se detyrimi i



organeve gjyqësore për të dhënë vendime gjyqësore të arsyetuara shtrihet, pa dallim, edhe mbi trupën gjyqësore që gjykon e merr vendime në dhomën e këshillimit.

10. Sipas GJEDNJ-së, bazuar në parimin që lidhet me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet gjyqësore duhet të paraqesin arsyet mbi të cilat bazohen. Gjykatat kanë detyrim t'i arsyetojnë vendimet e tyre (*H. kundër Belgjikës*, § 53) sidomos kur përpara Gjykatës së Lartë ngrihen pretendime me karakter kushtetues, pra janë të tilla që përmbajnë të drejtën për t'u ankuar përpara Gjykatës Kushtetuese pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë (*Hirvisaari k. Finlandës*, § 30)³. Në rastin e një gjykate apelimi, siç është në këtë rast Gjykata e Lartë, GJEDNJ-ja ka pranuar standardin e arsyetimit të përmbledhur, sidomos kur është rasti që konfirmohet një vendim i një gjykate më e ulët (*García Ruiz k. Spanjës [GC]*, § 26; *Gorou k. Greqisë (n°2) [GC]*, § 41).

11. Gjykata është shprehur se shqyrtimi paraprak vlerësues i rekurseve ka natyrë filtrimi seleksionues dhe, si i tillë, i është njohur si kompetencë vetëm trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të mbledhur në dhomën e këshillimit (*in camera*). Gjithashtu, në lidhje me formën dhe përmbajtjen e arsyetimit të vendimeve të mospranimit të rekurseve, Gjykata e Lartë ka krijuar tashmë një praktikë të konsoliduar. Në këtë linjë arsyetimi, sipas shumicës, pretendimet e ngritura në rekurs nuk janë të natyrës kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, u ka dhënë përgjigje përmes shprehjes se pretendimet nuk bëjnë pjesë në ato që parashikohen në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012 (*shih paragrafin 40 të vendimit*).

12. Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, për sa më sipër, mendoj se në rastin konkret vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk ka arritur të përmbushë kërkesat për t'u konsideruar i arsyetuar, në kuptim të normës kushtetuese dhe në respektim të kërkesave të dispozitave përkatëse procedurale. Sikurse përmendet më sipër, qëllimi i

arsyetimit të vendimit nga gjykatat është pikërisht t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe t'u japë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Procesi i filtrimit, seleksionimit, është në vetvete proces gjykimi e vendimmarrjeje dhe kërkon kujdes e shterim profesional të argumenteve, pavarësisht nëse zhvillohet në dhomën e këshillimit ose në seancë. Arsyetimi është mjet bindës, njëfarë “qetësuesi”, që kur bëhet i plotë ka shumë të ngjarë ta “çarmatosë”, dekurajojë palën ose palët që u kundërshtohet për të vijuar më tej procesin ligjor, që shpesh është i kushtueshëm, sidomos nga pikëpamja kohore. Pra, vazhdimi i procesit ka mundësi të ndodhë më rrallë, e ndofta fare, kur pretendimet marrin përgjigje sa më të qartë e të argumentuar hollësisht. Me fjalë të tjera, kërkesja në rastin konkret ka vijuar me kërkesën në Gjykatën Kushtetuese pikërisht sepse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arritur ta bindë me arsyetimin e vendimit të mospranimit të rekursit, duke i krijuar përshtypjen ose bindjen se nuk është dëgjuar dhe, për këtë shkak, i është cenuar e drejta e aksesit material në gjykim. Vetë fjala “arsyetim” në Fjalorin e Gjuhës Shqipe do të thotë: “*varg mendimesh e gjykimesh të parashtruara në mënyrë logjike për të shpjeguar diçka ose për të arritur një përfundim*.” Pra, një vendim mund të quhet i arsyetuar jo vetëm kur përmend ose referon pretendimet e parashtruara të palëve, por kur i analizon ato në një masë të caktuar përmes mendimeve e gjykimeve përkatëse, që çojnë në arritjen e një përfundimi logjik.

13. Referuar arsyetimit të gjykatave të faktit, në lidhje me padinë e gjykuar prej tyre, më konkretisht në lidhje me mënyrën e zbatimit nga ana e organit administrativ të akteve ligjore e nënligjore për amnistinë fiskale, rezulton se gjykata e shkallës së parë e ka gjetur të bazuar padinë dhe ka vlerësuar se në rastin konkret duhet të zbatohet neni 24 i ligjit nr. 10418/2011 dhe jo neni 18 i tij, të cilin e referon organi administrativ, si pala e paditur në procesin gjyqësor. Sipas gjykatës së shkallës së parë, organi administrativ ka gabuar në zbatimin e ligjit nr. 10418/2011, duke vlerësuar se kërkesja nuk mund të përfitonte nga amnistia fiskale as me anë të kompensimit të detyrimeve nëpërmjet gjendjes kreditore të TVSH ndaj organit tatimor, pasi gjendja kreditore tatimore nuk mund të përdoret për të mbuluar detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në

³ Kështu, duke mospranuar ankimin, gjykata që e shqyrton atë, në parim thjesht miraton arsyet e parashtruara në vendimin e gjykatës më të ulët (shih GJEDNJ: García Ruiz k. Spanjës, 21 janar 1999 dhe Helle k. Finlandës, 19 dhjetor 1997). Gjykata ose organi më i ulët, nga ana e vet, duhet të parashtrtojë arsyet për t'u mundësuar palëve që të përdorin efektivisht të çdo të drejtë të mundshme ankimi.



ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit ka vlerësuar se paditësja duhet ta kishte kundërshtuar në rrugë gjyqësore aktin administrativ të palës së paditur që i ka mohuar të drejtën e përfitimit nga amnistia fiskale, pa u shprehur për themelin e kërkrimeve të parashtruara në kërkesëpadi.

14. Gjithashtu, duke iu referuar shkaqeve të ngritura në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, të cilat janë pasqyruar edhe në përmbajtjen e vendimit të asaj gjykate, në njërin prej tyre shprehet pretendimi se Gjykata Administrative e Apelit ka zbatuar gabim ligjin material, nenin 24, të ligjit nr. 10418/2011, si dhe ka shkelur ligjin procedural, duke vendosur rrëzimin e padisë si e pabazuar në ligj, por pa vlerësuar pretendimet e palës paditëse. Sipas kërkuësës, kjo mënyrë e zbatimit të ligjit ka cenuar parimin e sigurisë juridike, i cili është një pretendim me natyrë kushtetuese.

15. Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv. Gjykata ka pohuar se në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra edhe Gjykata kur flet për termin “përgjigje”, e trajton atë si analizë, arsyetim, e jo thjesht përgjigje në formë lakonike.

16. Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese është vlerësuar si cenim i së drejtës për proces të rregullt ligjor kur gjykatat e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që u japin kodet përkatëse të procedurës, nuk plotësojnë ose nuk korrigjojnë mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, të cilat nuk përmbushin tërësisht ose mjaftueshmërisht standardet dhe elementet e domosdoshme që e bëjnë një proces ligjor të rregullt. Po ashtu, jurisprudenca kushtetuese ka trajtuar edhe qëndrimin që duhet të mbajë Gjykata e Lartë në rastet kur për zgjidhjen në themel të çështjes ka dy vendime diametralisht të kundërta nga gjykatat më të ulëta. Ky rast është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial,

si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuadrin e parimit të subsidiaritetit, Gjykata ka theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen konkrete në shqyrtim, duke vendosur mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore edhe pse vendimet e gjykatave më të ulëta janë diametralisht të kundërta, në fakt Gjykata e Lartë nuk e ka marrë përsipër këtë rol, duke mos korrigjuar gabimet e mundshme në vendimet e gjykatave të faktit, madje as nuk ka mirësuar pretendimet e kërkuësës në lidhje me to. Përfundimet e kundërta të gjykatave të faktit nuk kanë të bëjnë thjesht me mënyrën se si është zgjidhur në themel çështja, por me mënyrën e interpretimit të ligjit për sa i takon mjetit ligjor që duhej të zgjidhte kërkuësja (si paditëse) për të mbrojtur të drejtat e saj ligjore të pretenduara të cenuara. Ndërsa gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkuësja përfitonte nga amnistia fiskale dhe organi administrativ ka interpretuar gabim ligjin material, gjykata e apelit ka vlerësuar se ajo nuk duhej të kërkonte në gjykatë detyrimin e organit administrativ për t’i njohur faljen e gjobave dhe kamatëvonesave, por duhej të kundërshtonte aktin administrativ që i kishte rrëzuar asaj kërkesën për të përfituar nga ligji nr. 10418/2011. Ky vlerësim i gjykatës së apelit, i ndryshëm nga ai i shkallës së parë, ka të bëjë me të drejtën e kërkuësës për akses në gjykatë, e drejtë që përfshin jo vetëm mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe atë për të marrë përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e ngritura. Në këtë këndvështrim, vlerësoj se pretendimet e ngritura në rekurs, në thelb, kanë të bëjnë pikërisht me garantimin e së drejtës së aksesit nga gjykatat e faktit, si element i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, kontrolli i respektimit të së cilës është, para së gjithash e kryesisht, detyrë e Gjykatës së Lartë. Në kuptim të këtij detyrimi, Gjykata e



Lartë duhej të arsyetonte se përse pretendimet e ngritura në rekurs, të cilat, formalisht, i referohen atyre që norma procedurale ka përcaktuar si shkaqe që mund të ngrihen në atë gjykatë, ishin haptazi të pabazuara dhe përse nuk kishte vend për kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë gjyqësore. Edhe shumica, bazuar në parimin *jura novit curia*, duhej të kishte evidentuar të drejtën kushtetuese të cenuar kërkueses, e cila duke u parashtruar në thelb si shkak në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkonte një përgjigje të arsyetuar nga ajo gjykatë bazuar në standardet si më sipër.

18. Në vlerësimin tim, arsyetimi i shkurtuar i vendimeve të Gjykatës së Lartë në dukje nuk shfaq papajtueshmëri me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Por në kuptim të rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim dhe natyrës së pretendimeve të ngritura në rekurs, arsyetimi *de plano* i vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Administrativ nuk plotëson kërkesat për proces të rregullt, përkundrazi krijon paqartësi për palët, duke mos përmbledhur qoftë edhe një argumentim të shkurtuar të pretendimeve, çka jo vetëm do t'i bënte të kuptueshme shkaqet e këtij qëndrimi, por edhe do ta përligjte vendimmarrjen e gjykatës.

19. Vetë fakti që si Gjykata, ashtu edhe GJEDNJ-ja kanë rekomanduar se çështja e vëllimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore duhet të shihet në frymën e rrethanave konkrete të rastit, jep njëfarë “drite të gjelbër” për ta trajtuar çështjen pikërisht në mënyrë specifike. Në ligjin nr. 49/2012, neni 62, shkronja “c”, parashikohet se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kur gjykon çështjet në dhomë këshillimi duhet t'i kalojë në seancë kur ato paraqesin kompleksitet. Dhe, në fakt, çështja në fjalë nuk ishte aq e rrafshët, por paraqiste mjaftueshëm kompleksitet, prandaj edhe vendimi për mospranimin e rekursit duhet të ishte ndalur të paktën për të arsyetuar nëse ishin rrethanat e parashikuara në kuptim të përmbajtjes së shkronjës “a” të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 (vendimi nr. 00-2017-1692, datë 26.09.2017 i Gjykatës së Lartë).

20. Në përfundim, duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, pa u dhënë përgjigje përfundimtare në mënyrë më të arsyetuar pretendimeve të ngritura në rekurs, vlerësoj se Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor, si standard dhe

njëkohësisht element i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, i sanksionuar në Kushtetutë, veçanërisht në nenet 42, 43 dhe 142, pika 1, të saj. Në kushtet kur jo vetëm procedura e shqyrtimit të rekursit, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të saj, por edhe përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë është i vesuar nga pikëpamja kushtetuese, Gjykata duhej ta kishte pranuar tërësisht kërkesën, duke vendosur edhe shfuqizimin e vendimit nr. 00-2017-1692, datë 26.9.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë. Vlerësoj se qëndrimi i shumicës, duke e pranuar pjesërisht kërkesën, nuk arrin të garantojë ankimin kushtetues material, pra rivendosjen e të drejtave të cenuara të kërkueses, çka do të bëhej e mundur vetëm duke vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Shpallur më 13.4.2021.

Anëtar: Përparim Kalo

NJOFTIM

Nr. 4703, datë 19.4.2021

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë, mbi ndihmën Grant të Japonisë, Programi i Zhvillimit Ekonomik dhe Social (Sigurimi i pajisjeve mjekësore)”, nënshkruar në Tiranë, më 3 shkurt 2021, ka hyrë në fuqi më 2 prill 2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Arman Skrap



UDHËZIM
Nr. 6, datë 6.4.2021

**PËR ZBATIMIN E KOEFICIENTËVE
TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË
VLERËSUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 196,
DATË 31.3.2021, “PËR INDEKSIMIN E
PENSIONEVE DHE BAZËS SË
VLERËSUAR”**

Në zbatim të pikës 11, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 31.3.2021, “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”, me qëllim zbatimin e drejtë dhe unik të tij, Instituti i Sigurimeve Shoqërore

UDHËZON:

Në zbatim të pikës 11, të vendimit nr. 196, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, baza e vlerësuar e vitit 2019 do të indeksohet me indeksin

2,8%, të llogaritur sipas kriterëve të përcaktuara në nenin nr. 59, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensioneve me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 3.10.2018, “Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve” dhe me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, “Për koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për llogaritjen e pensioneve”, vendim të Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 30.3.2020, “Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve”, shtohen edhe me koeficientin 2.8 për qind, të përcaktuar në pikën “11” të këtij vendimi, konkretisht si më poshtë:

Për pagat referuese deri më datë 31.12.1993	9.562
Për pagat e vitit 1994	9.562
Për pagat e vitit 1995	7.696
Për pagat e vitit 1996	5.971
Për pagat e vitit 1997	5.971
Për pagat e vitit 1998	4.989
Për pagat e vitit 1999	4.049
Për pagat e vitit 2000	3.689
Për pagat e vitit 2001	3.155
Për pagat e vitit 2002	2.914
Për pagat e vitit 2003	2.608
Për pagat e vitit 2004	2.369
Për pagat e vitit 2005	2.151
Për pagat e vitit 2006	1.954
Për pagat e vitit 2007	1.867
Për pagat e vitit 2008	1.649
Për pagat e vitit 2009	1.517
Për pagat e vitit 2010	1.452
Për pagat e vitit 2011	1.397
Për pagat e vitit 2012	1.344
Për pagat e vitit 2013	1.288
Për pagat e vitit 2014	1.288
Për pagat e vitit 2015	1.113
Për pagat e vitit 2016	1.113
Për pagat e vitit 2017	1.092
Për pagat e vitit 2018	1.053
Për pagat e vitit 2019	1.028
Për pagat e vitit 2020	1.000
Për pagat e vitit 2021	1.000



Koeficientët e sipërshtënëuar aplikohen për rrvlerësimin e bazës së vlerësuar të arritur deri në vitin 2021, për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit që do të caktohet me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim. Pas aplikimit të tij, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit që do të caktohet me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk mund të jetë më e lartë, se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 30 000 lekësh, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2020, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi prej 130 312 lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit të nenit nr. 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

Indeksi i pagave me koeficientët e pasqyruar më sipër, për efekt të llogaritjes fillestare të pensioneve, do të bëhet vetëm për pensionet me datë lindjeje të së drejtës nga data 1.4.2021 e në vazhdim.

Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 3.10.2018, “Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, “Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 30.3.2020, “Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve”, mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.3.2021, përfshirë edhe këtë datë referuar datës së lindjes të së drejtës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Astrit Hado

VENDIM
Nr. 83, datë 30.3.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “REI – ENERGJI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LINGJACA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1897 kW, HEC “LINGJACA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 300 kW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 2197 kW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/2 prot., datë 24.3.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “Rei – Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 kW dhe “Lingjanca 2”, me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 kW, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 56, datë 22.2.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “REI – ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 kW, HEC “Lingjanca 2”, me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Lingjancës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 25 vjet e 10 muaj.

- Në vijim të vendimmarjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/8 prot., datë 22.2.2021, është bërë publikimi në medien e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et: “Lingjanca 1” dhe HEC “Lingjanca 2”



dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezulton të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 424 prot., datë 5.3.2021, ka njoftuar shoqërinë “Rei – Energi” sh.p.k., lidhur me vendimmarrjen e Bordit, për fillimin e procedurave për licencimin e saj në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 56/2021.

- Shoqëria “Rei – Energi” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 424/1 prot., datë 16.3.2021, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Rei – Energi” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”, plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar;

- Dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”. Plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Shoqëria ka saktësuar edhe emërtesën e HEC-eve duke konfirmuar se emërtesa e saktë është: “Lingjanca 1 dhe Lingjanca 2” dhe përdorimi në disa nene të kontratave me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si Lingjanca është gabim ortografik.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë e Përrenjasit (data e përfundimit:

13.05.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Kontrata nr. 57 REP., nr. 16 KOL., datë 23.1.2012, “Kontratë e formës BOT ndërtim-operim-transferim, për ndërtimin e hidrocentralit “Lingjanca””; ka një afat 35-vjeçar, por, nga ana tjetër, shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Në rastin konkret konstatohet se kontrata e koncesionit sipërcituar është nënshkruar në datën 23.1.2012 (data efektive) dhe si e tillë shoqëria ka humbur 9 vite nga periudha e koncesionit.

Në nenin 5, “Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës”, pika 2, të rregullores së licencimit përcaktohet se: për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave”.

Sa më sipër, nisur nga llogaritja e afateve të humbura të koncesionit, kjo shoqëri duhet të licencohet për një periudhë 25 vjet e 10 muaj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rei – Energi” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 *kw*, HEC “Lingjanca 2” me kapacitet të instaluar 300 *kw*, me kapacitet total të instaluar 2197 *kw*, për një afat 25 vjet e 10 muaj.

2. Shoqëria “Rei – Energi” sh.p.k., në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Përrenjas (data e përfundimit 13.5.2027), duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 84, datë 30.3.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“BALKGAZ” SHPK PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT TË ERE-s PËR
NDRYSHIMIN E ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe nenit 9, pika 2, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 24, datë 30.1.2018, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/1 prot., datë 23.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror,

konstatoi se:

- Shoqëria “Balkgaz” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 433, seria TGN18, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 256, datë 17.12.2018.

- Me shkresën e datës 10.2.2021, protokolluar në ERE me nr. 294 prot., datë 10.2.2021, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e ndryshimit të ortakut të vetëm të shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k.

- Kërkesa e shoqërisë vjen në zbatim të nenit 9, pika 2, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, ku përcaktohet se: “Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri

kryesor/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizim nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re sipas rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Duke qenë se me shkresën nr. 294 prot., datë 10.2.2021, është paraqitur vetëm kërkesa e shoqërisë për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të saj dhe arsyet për këtë ndryshim, pa u shoqëruar me dokumentacion, dhe duke qenë se në rastin e autorizimeve, ERE shprehet me vendim direkt u vijua me dërgimin e shkresës nr. 294/1 prot., datë 22.1.2021, nëpërmjet së cilës ka orientuar shoqërinë mbi dokumentacionin e nevojshëm për këtë procedurë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me numër 294/2 prot., datë 19.3.2021, është paraqitur i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e miratimit nga ana e ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k.

- Shoqëria “Balkgaz” sh.p.k., ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., nga shoqëria “Hgen Enerji Limited Şirketi”, te z. Laid Saath Wadie Habboush.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti



VENDIM
Nr. 85, datë 30.3.2021

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
DORËZIMIT TË PROGRAMIT TË
PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT
TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR
GAZIN NATYROR, “ALBGAS” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/6 prot., datë 29.3.2021, të përparës nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 1.3.2021, ka vendosur:

Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.;

- Në vijim, duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria “Albgaz” sh.a., nuk ishte sqaruar ende plotësisht për përditësimin e konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263/2020 në Programin e përputhshmërisë e mund të ishte i nevojshëm dhe organizimi i një takimi virtual për këtë qëllim, si dhe duke mbajtur pasur parasysh faktin që shoqëria ishte në fazën e përkthimit të programit, i cili duhet dërguar dhe për opinionet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 1.3.2021, vendosi:

Zgjatjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë, për miratimin e Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.

- Me shkresën e datës 18.3.2021, shoqëria ka kërkuar zgjatjen deri më 10.8.2021, të afatit të dorëzimit të Programit të përputhshmërisë, të përditësuar sipas konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 28.12.2020, me anë

të të cilit filloi dhe procedura për miratimin e këtij programi.

- Në mbështetje të kërkesës së saj për zgjatjen e afatit, shoqëria bëri me dije se, duke qenë se nuk u realizua dot një takim për shkak të kushteve të COVID-19, për të sqaruar përfundimisht çështjet e ngritura në vendimin për fillimin e procedurës, shoqëria deklaroi se ka nisur një procedurë të brendshme për implementimin e sugjerimeve dhe se ndryshimet në Programin e përputhshmërisë duhet të miratohen në disa hallka drejtuese të brendshme të shoqërisë, si Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme e “Albgaz” sh.a.

- Lidhur me sa parashtruar nga shoqëria “Albgaz” sh.a., në shkresën e datës 18.3.2021, sqarojmë se afati i kërkuar nuk është i justifikuar dhe, për këtë arsye, gjykohet shtyrja e tij me 3 muaj, përkatësisht deri më 30 qershor 2021.

- Në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

3. Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Kërkesa e shoqërisë është depozituar brenda afatit të shtyrë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63/2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më 30.6.2021 afatin e dorëzimit të Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftoj palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 86, datë 30.3.2021

**MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 63,
SERIA NPM08P, DHËNË SHOQËRISË
“ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK,
ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 89, DATË 6.8.2008, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 7, 8 dhe 9, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/3 prot., datë 24.3.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 36, datë 4.2.2021, vendosi:

- Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar.

- Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., nr. 63, seria NPM08P.

- Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimarrje të Bordit nëpërmjet shkresës nr. 51/3 prot., datë 11.2.2021, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.

- Nuk rezulton që shkresa e dërguar të jetë kthyer mbrapsht nga posta, ndaj konsiderohet se shoqëria ka marrë dijeni për vendimarrjen e Bordit të ERE-s.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar prej 30 ditësh nga marrja dijeni, shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., nuk ka depozituar në ERE as informacion dhe as dokumentacion dhe nuk ka

marrë masa për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d” të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe ajo nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 63, seria NPM08, dhënë shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albanian Green Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 87, datë 30.3.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 59,
SERIA NPM08P, DHËNË SHOQËRISË
“ERS-08” SHPK, ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 63, DATË
13.6.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 7, 8 dhe 9, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/4 prot., datë 24.3.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 33, datë 4.2.2021, vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., nr. 59, seria NPM08P.

3. Shoqëria “ERS-08” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimarrje të Bordit nëpërmjet shkresës nr. 306, datë 11.2.2021, përmes së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.

- Nuk rezulton që shkresa e dërguar të jetë kthyer mbrapsht nga posta, ndaj konsiderohet se shoqëria ka marrë dijeni për vendimarrjen e Bordit të ERE-s.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar prej 30 ditësh nga marrja dijeni, shoqëria “ERS-08” sh.p.k., nuk ka depozituar në ERE as informacion dhe as dokumentacion dhe nuk ka marrë masa për të

shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria “ERS-08” sh.p.k., nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe ajo nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 59, seria NPM08, dhënë shoqërisë “ERS-08” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ERS-08” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 88, datë 31.3.2021

**MBI KËRKESËN E ZYRTARIT TË
PAJTUESHMËRISË TË OST SHA
PËR SHTYRJEN E AFATIT TË
DORËZIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË
PAJTUESHMËRISË SË OPERATORIT
TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, kreut VI, germa C, pika 1, të Programit të Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 30.4.2018, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2021, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e zyrtarit të pajtuëshmërisë të OST sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të pajtuëshmërisë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 103, datë 30.4.2018, ka vendosur të miratojë Programin e Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

- Në kreun VI, germa C, pika 1, të këtij programi, përcaktohet si vijon: Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i pajtuëshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për pajtuëshmërinë e OST-së me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s.

- Me *e-mail*-in e dërguar në ERE në datën 26.3.2021, Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST sh.a., i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrje të afatit të dorëzimit të raportit të pajtuëshmërisë së OST sh.a. për vitin 2020, me 7 (shtatë) ditë pune nga data 31 mars që është afati i fundit për dorëzimin e tij. Kjo kërkesë vjen si rezultat i gjendjes shëndetësore të ditëve të fundit të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së OST sh.a., i cila nga testimi i datës 23 mars 2021, ka rezultuar pozitiv ndaj COVID-19.

- Duke marrë në konsideratë gjendjen e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë për shkak të infektimit me COVID-19, vlerësojmë marrjen parasysh të kërkesës së Zyrtarit të Pajtuëshmërisë për të shtyrë afatin e dërgimit të Raportit Vjetor për vitin 2020, por duke caktuar një kohë prej 14 (katëmbëdhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data 31 mars. Zgjatja e afatit të kërkuar nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë sugjerohet për t'i dhënë mundësinë e dorëzimit të raportit vjetor, pas rikuperimit të plotë nga pandemia COVID-19. Sikurse jemi në dijeni, shërimi nga kjo pandemi kërkon një periudhë më të gjatë sesa 7 (shtatë) ditë pune, për këtë arsye mendojmë se është e arsyeshme zgjatja e afatit të kërkuar nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST sh.a. deri në datën 20.4.2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, germa C, pika 1, të Programit të Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 30.4.2018, deri në datën 20.4.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Zyrtarin e Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 89, datë 31.3.2021

**MBI PROPOZIMIN E SHOQËRISË
OPERATORI I SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT SHA, “PËR
RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË
BALANCIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA DATA 1 PRILL 2021”**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë



elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjiave nga burime të rinovueshme”, si dhe të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/7 prot., datë 26.3.2021 dhe relacionin shtesë nr. 39/9, datë 30.3.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi propozimin e Shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) për rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nga data 1 prill 2021”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrje të afatit të hyrjes në fuqi të vendimit nr. 106, datë 2.7.2020”, ndër të tjera vendosi:

“ - Të pranoj pjesërisht kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të zbatimit nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, pa efekte financiare (*Dry run*) deri në datën 31.3.2021, të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, Mbi miratimin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike’.

- OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijnë në aplikimin e periudhës *Dry run* deri në datën 31.3.2021.

- OST sh.a., me shkresën nr. 1917 prot., datë 18.3.2021, drejtuar ERE-s, parashtroi si më poshtë vijon:

- Procesi i regjistrimit në Tregun Balancues:

OST sh.a. propozon që, pas datës 1 prill 2021 deri në miratimin e ndryshimeve të propozuara më parë, të vijohet me formularët e pandryshuar, rubrikat të cilat nuk mund të plotësohen, të lihen bosh (me vizë).

- Llogaritja e garancisë:

OST sh.a. propozon që, pas datës 1 prill 2021 deri në miratimin e ndryshimeve të propozuara më parë, të aplikohet metodologjia e llogaritjes së garancisë sipas praktikës së ndjekur deri më tani, në përputhje me propozimin e OST-së.

- Rezolucioni 15 minutësh:

OST sh.a. propozon që, pas datës 1 prill 2021 deri në përfundimin e *upgrade*-it të platformës për proceset e Tregut Balancues, të vijojë të përdoret rezolucioni 1 orarësh....”.

Për sa parashtruar nga OST sh.a., në shkresën nr. 1917 prot., datë 18.3.2021, ERE vlerëson se:

- Lidhur me procesin e regjistrimit në Tregun Balancues:

Duke marrë në konsideratë faktin që procesi i regjistrimit ka funksionuar si edhe është parashtruar nga OST sh.a. në raportimet përgjatë periudhës *Dry run* ku janë parakualifikuar disa OSHB, si dhe të gjithë palët përgjegjëse për balancimin kanë marrë pjesë në procesin *Dry run*, ky proces nuk ka cenuar funksionimin e Tregut të balancimit për periudhën *Dry run*. Në këto kushte OST sh.a. të vijoj regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut me formularët aktualë në fuqi të cilët janë përdorur dhe gjatë periudhës *Dry run*.

Në çdo rast OST sh.a. duhet të aplikojë formular të njëjtë, si dhe marrëveshje të njëjta për të gjithë pjesëtarët e Tregut të Balancimit. Nuk duhet të ketë diskriminim dhe aplikim i formularëve të ndryshëm apo marrëveshjeve të ndryshme të pjesëtarëve të Tregut të Balancimit në asnjë rast.

Lidhur me këtë, gjykojmë se fillimi për herë të parë në datën 1 prill 2021 i procesit të operimit të Tregut të Balancimit në vendin tonë përbën një risi për sektorin e energjisë elektrike, për rrjedhojë, përgjatë periudhës 1 prill 2021 deri në 30 qershor 2021 OST sh.a. të rishikojë propozimet e bëra, nëse kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme gjatë operimit të Tregut të Balancimit në kushte reale, dhe të bëjë propozimet përkatëse në ERE, nëse do të jetë e nevojshme.

Në këto rrethana, për periudhën 1 prill 2021 – 30 qershor 2021 OST sh.a. të vijojë procesin e regjistrimit të pjesëmarrësve në Tregun e Balancimit me formularët e pa ndryshuar, sikurse është vepruar gjatë periudhës *Dry run*. Rubrikat të cilat nuk mund të plotësohen, të lihen të pa plotësuar duke argumentuar arsyet përse nuk mund të plotësohet një rubrikë rast pas rasti.

- Lidhur me llogaritjen e garancisë:

Duke marrë në konsideratë faktin se propozimi i OST sh.a. është që të përdoret mekanizmi aktual i përcaktuar në “Rregullat e mekanizmit të përkohshëm të balancimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, gjykohet se për një periudhë kohore të ndërmjetme disa mujore të shikohet mundësia e aplikimit të këtij mekanizmi dhe me rregullat e Tregut të



Balancimit të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

Duke qenë se OST sh.a. është operuese e Tregut të Balancimit, si dhe propozuese e këtij mekanizmi të garancive financiare, për pjesëmarrësit në Tregun e Balancimit, duhet të garantojë procesin e shlyerjes së disbalancave dhe shlyerjen e detyrimeve financiare për të gjitha palët që marrin pjesë në Tregun e Balancimit, nga data 1 prill e në vijim, kur do të aplikohen me efekte të plota rregullat e balancimit të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

Kjo periudhë do të shërbejë për të parë eficiencën e këtij mekanizmi dhe bazuar në aplikimin e këtyre 3 muajve, të këtij mekanizmi të garancisë financiare, të përcaktuar në “Rregullat e mekanizmit të përkohshëm të balancimit”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 193, datë 24.11.2017.

- Lidhur me rezolucionin 15 minutësh:

Sistemi i matjes së OST sh.a. realizon matje të energjisë elektrike me interval 15 minuta dhe për rrjedhojë me interval orar, problematika e evidentuar nga OST sh.a. lidhet kryesisht me ndërfaqen e këtij sistemi me platformën elektronike, për realizimin e nominimeve dhe llogaritjeve respektive me interval kohor 15 minutësh.

Aplikimi i intervalit kohor prej 1 ore, nga viti 2017 deri më sot, nuk ka sjellë asnjë vështirësi për pjesëmarrësit dhe për rrjedhojë mund të vijojë të përdoret për një afat kohor të kufizuar. Kjo do të krijonte mundësi dhe për aplikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106/2020 dhe për disiplinimin/funksionimin e pjesëmarrësve të Tregut të Balancimit me rregullat e reja me efekte financiare.

- ERE bën gjithashtu me dije se, sa u përket interesave që palë të treta mund të kenë në lidhje me këtë akt rregullator, sqarojmë se dokumentacioni përkatës është publikuar në faqen zyrtare të ERE-s, www.ere.gov.al, në rubrikën konsultime, me qëllimin që çdo palë e interesuar të njihet paraprakisht me këtë dokument, apo çdo palë që mund të ketë interes të ligjshëm për të shprehur qëndrim në lidhje me përmbajtjen e tij, të mund të konsultohet me dokumentin e të mund të përcjellë në ERE opinion brenda afateve të parashikuara në ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin

dhe konsultimin publik”, në lidhje me sa propozuar nga OST sh.a.

- Gjithashtu, evidentohet se, sa i përket “Komponentes nxitëse”, deri në përfundimin e shqyrtimit në ERE të propozimeve të dërguara për ndryshim nga OST sh.a, përcaktimet për “Komponenten nxitëse” mbeten ato të përcaktuar në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, konkretisht vlera fillestare, siç përcaktuar në pikën 3.5, germa “a”, të aneksit të këtyre rregullave, është € 0/mwh.

- OST sh.a., në datën 30.3.2021, zhvilloi një seancë *online* diskutimi me palët e interesuara, lidhur me fillimin e zbatimit të rregullave të Tregut të Balancimit me efekte të plota nga data 1 prill 2021, bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 275, datë 28.12.2020, i cili zgjati periudhën e zbatimit të rregullave të miratuara me vendimin e Bordit nr. 106, datë 2.7.2020, pa efekte financiare, deri në 31.3.2021. Në këtë seancë *online* ishin të pranishëm përfaqësues nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE Group sh.a.), Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.), Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), si dhe Devoll Hydropower.

- Në këtë seancë, OST sh.a. bëri një paraqitje të ecurisë së periudhës *Dry Run* ku evidentoi se në vijim të ecurisë së kësaj periudhe, por dhe duke u bazuar në përcaktimet e rregullave të balancimit, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020, komponentja nxitëse do të aplikohet në këtë fillim të zbatimit të rregullave, me efekte financiare në vlerën zero.

- AAES përshëndeti fillimin e Tregut të Balancimit, për herë të parë nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, duke marrë në konsideratë që kostot e këtij shërbimi të jenë sa më minimale dhe OST sh.a. të jetë në pozicion neutral sa u përket kostove të Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike. Në të njëjtën kohë, AAES u shpreh se mbështet faktin e aplikimit të komponentes nxitëse me vlerë fillestare zero.

- Shoqëria KESH sh.a. ngriti shqetësimin se si ofrues i shërbimit të balancimit mbajtja e komponentes nxitëse zero nuk është në interes të



ofruesve të shërbimit të balancimit, dhe për rrjedhojë shprehu mos dakordësinë për të aplikuar komponenten nxitëse zero.

- Lidhur me këtë, vlerësojmë se “Rregullat e Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike”, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, në aneksin 12.4, pika 3.5, përcaktojnë se:

- “3.5 Komponentja nxitëse:

a) vlera fillestare: €0/mwh;

b) rregullimet e komponentes nxitëse.

- 3.5.b.1 OST-ja do të rregullojë komponenten nxitëse në bazë të kriterëve objektive, sipas një procedure të përcaktuar dhe të publikuar nga OST-ja në faqen zyrtare.

- 3.5.b.2 Vlera aktuale e komponentes nxitëse do të publikohet në faqen zyrtare të OST-së.

- 3.5.b.3 ERE ka të drejtën në çdo kohë të shqyrtojë procedurën për rregullimin e komponentes nxitëse dhe nëse është e nevojshme i kërkon OST-së ta dërgojë këtë procedurë për t’u miratuar në ERE dhe ta përfshijë si pjesë e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit.

- Duke marrë në konsideratë këto përcaktime të Rregullave, sipërcituar, vlerësojmë se OST sh.a., në përcaktimin e komponentes nxitëse në vlerën 0 eur/mwh, është në përputhje me rregullat e Tregut të Balancimit, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020. Në çdo rast OST sh.a., duhet të përdorë, në përputhje dhe me rregullat e Tregut të Balancimit, komponenten nxitëse vetëm për të disiplinuar Tregun e Balancimit të Energjisë Elektrike, për të eliminuar keqpërdorimin e këtij mekanizmi.

- AREA parashtroi në takim, ndër të tjera, se OST sh.a. nuk ka përfshirë prodhuesit me përparësi në projektin për “Zbatimin e Rregullave të Tregut për Balancimin e Energjisë Elektrike”, si dhe prodhuesit me përparësi nuk kanë marrë asnjë informacion për zbatimin e testit *Dry run*, pra të informohen se çfarë efekte financiare të pritshme do të ketë balancimi i prodhimit të tyre.

- Për sa parashtruar nga shoqata AREA, OST sh.a. bëri me dije se, në faqen *web* të OST sh.a., është hapur një rubrikë për procesin e *Dry run*, si dhe faktin se OST sh.a. ka njoftuar FTL sh.a., e cila agregon dhe dërgon skedulet në OST sh.a. për efekt të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, dhe për rrjedhojë OST sh.a., njeh si përgjegjëse për balancimin FTL sh.a. në këtë

proces. OST sh.a., gjithashtu inkurajoi një takim për ngritjen e grupeve të balancimit për të minimizuar kostot që mund të vijnë për shkak të balancimit.

- Lidhur me pretendimet e AREA-s, në takimin *online* të datës 30.3.2021, si dhe për sa parashtruar në shkresën e saj nr. 1810/98 prot., datë 29.3.2021, e bërë me dije në ERE përmes *e-mail*-it të datës 29.3.2021, shkresë nr. prot. 1810/99, datë 30.3.2021, shkresë nr. prot. 1810/100, datë 30.3.2021, shkresë nr. prot. 1810/101, datë 30.3.2021, shkresë nr. prot. 1810/102, datë 31.3.2021, si dhe për sa parashtruar në kërkesat e shoqërive: i. AGE Sunpower sh.p.k., me shkresën nr. prot. 144, datë 30.3.2021, “Mbi përgjegjësisë e balancimit”; ii. SONE sh.p.k., shkresë nr. prot. 36, datë 30.3.2021, “Mbi përgjegjësitë e balancimit”; iii. AED Solar sh.p.k., shkresë nr. prot. 35/1, datë 30.3.2021, “Mbi përgjegjësitë e balancimit”, dhe shkresë nr. prot. 506, datë 30.3.2021, “Mbi përgjegjësitë e Balancimit”; iv. FTL sh.a., shkresë nr. prot. 935, datë 31.3.2021, “Mbi zbatimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nga data 1 prill 2021”; v. Seman 1 Solar sh.p.k., me shkresë datë 30.3.2021, “Mbi përgjegjësitë e balancimit”; vi. Seman 2 Sun sh.p.k., shkresë nr. prot. 3019, datë 30.3.2021, “Mbi përgjegjësitë e Balancimit”; vii. Seman Sun Power sh.p.k., shkresë nr. prot. 16, datë 30.3.2021, “Mbi përgjegjësitë e balancim”, vlerësojmë se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi: “Miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”. Në këtë vendim është përcaktuar faza e parë e zbatimit të këtyre rregullave në procesin *Dry run*, deri në datën 31.12.2020, fazë e cila u zgjat me një periudhë të dytë deri në datën 31 mars 2021. Procesi për miratimin e Rregullave të Tregut të Balancimit ka filluar që në vitin 2019. Shoqëria OST sh.a., bazuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëpërmjet shkresës me nr. 3053 prot., datë 7.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 330 prot., datë 9.5.2019, ka përcjell për shqyrtim dhe miratim draftin përkatës të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 118, datë 22.7.2019, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të



Balancimit të Energjisë Elektrike”, bashkë me anekset përkatëse, të propozuara nga OST sh.a.

- Në vijim të vendimit nr. 118, datë 22.7.2019, palët e interesit u njoftuan me anë të shkresës nr. 330/2 prot., datë 31.7.2019, në mënyrë që të diskutoheshin më tej disa aspekte të parashikimeve të këtyre rregullave dhe të merrej opinioni i palëve të interesit. Ndër të tjera, nëpërmjet kësaj shkrese janë njoftuar për të dhënë opinionet përkatëse: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoriteti i Konkurrencës (AK), OSHEE sh.a., KESH sh.a., AAES, Shoqata *Foreign Investors Association of Albania* (FIAA), AREA.

- Në vijim, po me palët e interesit, ERE, më datë 10.10.2019, zhvilloi një seancë dëgjimore, ku ka qenë prezent edhe AREA.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar në nenin 99, pika 1, përcakton qartë se: “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.”.

- Në pikën 2, të po këtij neni, përcaktohet se: “Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut”.

- Si dhe evidentuar më sipër, ligji përcakton detyrimin për përgjegjësinë e balancimit, si dhe krijon kushte për një përfshirje të drejtpërdrejtë si palë përgjegjëse për balancimin apo edhe si grup balancimi. Palët, përfshirë dhe prodhuesit me përparësi, duhet të vlerësojnë vetë se cilat nga format e lejuara nga ligji, ajo e krijimit të një grupi balancimi apo ajo e të qenurit si palë përgjegjëse për balancimin është me kosto sa më minimale për ta.

- Gjithashtu, ligji nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjive nga burime të rinovueshme”, në nenin 22, pika 5, përcakton specifikisht se: “Deri në krijimin e tregut të balancimit, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2022, prodhuesit ekzistues me përparësi nuk do të jenë përgjegjës për kostot e disbalancave të shkaktuara. Këto kosto do të merren në konsideratë nga ERE në tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Prodhuesit ekzistues me përparësi do të njoftojnë skedulën e prodhimit tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

- Në çdo rast, duhet theksuar se, nga ana e operatorit apo palës përgjegjëse balancuese, për mënyrën e trajtimit të disbalancave të shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut, do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

- Në të njëjtën kohë, “Kontrata për shit-bleje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016, ndryshuar me vendimin nr. 255 datë 24.12.2018, në nenin 5 (Programet e livrimit), pika 5, përcakton se: “Devijimet nga programet e paraqitura do të trajtohen në përputhje me rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike apo çdo akti tjetër të miratuar nga ERE për këtë qëllim.”. Kontratë kjo e cila është nënshkruar nga vetë këta prodhues, si pala direkte në të, dhe është në zbatim e sipër.

- Për sa i takon pretendimit për mos llogaritjen e kostove të disbalancave, duhet thënë se tregu i disbalancave dhe llogaritjet bëhen në *ex post*, është e pamundur në *ex ante* të bëhen llogaritjet e kostove të disbalancave pasi tregu është dinamik dhe me kosto të cilat variojnë në baza orare dhe ditore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. OST sh.a. të vijojë procesin e regjistrimit të pjesëmarrësve në Tregun e Balancimit me formularët e pa ndryshuar, sikurse është vepruar gjatë periudhës *Dry run*. Rubrikat të cilat nuk mund të plotësohen të lihen të pa plotësuara, duke argumentuar arsyet përse nuk mund të plotësohet një rubrikë rast pas rasti.

2. Mekanizmi i garancisë financiare, që OST sh.a. do të aplikojë për pjesëmarrësit në Tregun e Balancimit, të jetë ai i përcaktuar në rregullat e Mekanizmit të Përkohshëm të Balancimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

3. Për periudhën deri në 30 qershor 2021, periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 orë.



4. Shoqëria OST sh.a. të raportojë dhe të dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

5. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OST sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK), OSHEE sh.a., KESH sh.a., FTL sh.a., FSHU sh.a., AAES, Shoqatën *Foreign Investors Association of Albania* (FIAA), AREA, AGE Sunpower sh.p.k., Sone sh.p.k., AED Solar sh.p.k., Seman 1 Solar sh.p.k., Seman 2 Sun sh.p.k., Seman Sun Power sh.p.k., Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë Elektrike mbi vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 97, datë 7.4.2021

**MBI MIRATIMIN E TREGUESEVE PËR
KRITERET STANDARDE TË CILËSISË
SË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT DHE
PERFORMANCËS SË SIGURISË SË
RRJETIT TË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 104, pika 4 dhe nenit 113, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 15 dhe 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; rregullores “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-

s nr. 181, datë 10.11.2017, Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 40/1 prot., datë 31.3.2021, të Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Standardeve, “Mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, miratoi rregulloren “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me kërkesë të shoqërisë OSHEE sh.a./OSSH sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, për shkak të nevojës së kryerjes së investimeve të domosdoshme, Bordi i ERE-s, me vendime të herëpashershme, ka vendosur shtyrjen e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

- Me vendimin nr. 175, datë 14.11.2019, “Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s vendosi:

“Ndryshimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 104, datë 26.6.2019, si më poshtë:

Pika 7.3, e rregullores “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OSHEE sh.a., do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 1.1.2021”.

- Lidhur me standardet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në zbatim të përcaktimeve ligjore të shprehura në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe rregullores sipërcituar, ndërmjet ERE-s dhe OSSH sh.a., ka pasur komunikim të vazhdueshëm lidhur me raportimin në ERE të treguesve të realizuar.

- Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) së bashku me Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë (BPSH), nëpërmjet shkresës së përbashkët me nr. 3 dhe nr. 140, datë 10.2.2020,



të protokolluar në ERE me nr. 296 prot., datë 11.2.2021, kanë paraqitur në ERE komente lidhur me rregulloren “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në vijim të shkresës sipërcituar, OSSH sh.a., nëpërmjet shkresës së dërguar në ERE, në adresën zyrtare të e-mail-it: erealb@ere.gov.al, të protokolluar me nr. 432 prot., datë 8.3.2021, ndër të tjera, parashtroi gjithashtu pretendimet e saj lidhur me rregulloren “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- ERE, lidhur me sa parashtuar nga OSSH sh.a., AEES dhe BPSH, sqaron se:

- Duke mbajtur në konsideratë shqetësimet e ngritura nga ky grup interesi, ERE, në datën 25.1.2021, ka realizuar një seance dëgjimore *online*, me përfaqësues të Shoqatës Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, ku ishin të ftuar dhe biznese prodhuese, anëtarë të shoqatës, si dhe përfaqësues të OSSH sh.a., në mënyrë që të adresonte direkt shqetësimet e ngritura.

- Me vendimin e Bordit nr. 175, datë 14.11.2019, mbi kërkesën e OSHEE sh.a., për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, është vendosur ndryshimi i pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 104, datë 26.6.2019, si më poshtë:

Pika 7.3 e rregullores “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OSHEE sh.a., do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 1.1.2021”. Pra, siç edhe evidentohet, deri në janar 2021, nuk kanë qenë të propozuara nga OSSH sh.a. kriteret standarde të cilësisë së shërbimit në rrjetin e shpërndarjes.

- Fakti që kjo rregullore, e miratuar me vendimin nr. 181/2017, përgjatë një periudhe disavjeçare nuk ka qenë në fuqi e bën të pamundur për të vlerësuar mbi eficiencën e saj apo dhe me ndikimin e saj në tregun dhe sektorin e energjisë elektrike në tërësi, si dhe performancën e ofruar nga OSSH sh.a., në veçanti. Ky element e bën të pamundur aktualisht që të gjykohet në mënyrë

shteruese mbi komentet e bëra nga AAES-ja dhe BPSH-ja, në shkresën e përbashkët me numra respektivë protokolli nr. 3, dhe nr. 140, datë 10.2.2020, protokolluar në ERE me nr. 296, datë 11.2.2021.

Në këto rrethana, gjykohet se komentet e bëra nga këto dy shoqata, aktualisht janë të parakohshme. Vlerësojmë se miratimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren e miratuar me vendimin nr. 181/2017, dhe vënia në fuqi e tyre me të gjitha efektet që ato kanë, do të shërbejë për të vlerësuar efikasitetin e kësaj rregulloreje.

- Lidhur me studimin për përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuar sipas katër zonave, realizuar nga OSSH sh.a., sqarojmë se:

- Dokumenti i përcjellë nga OSSH sh.a., me shkresën nr. 9626/2 prot., në vetvete parashton vlerësime lidhur me kërkesën e OSSH sh.a., por nuk përfshin një analizë të detajuar teknike, administrative apo dhe financiare lidhur me kriteret standarde të cilësisë së shërbimit që duhet të përcaktohen sipas rregullores së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017.

- Operatoret e rrjetit OSSH sh.a. dhe OST sh.a. duhet në çdo kohë të realizojnë studime, me qëllim që të evidentojnë problematikat e rrjetit dhe të përcaktojnë prioritetet për ndërhyrje rehabilituese, në ato pjesë të rrjetit/zona që shfaqin problematikë të shtuar sa i përket cilësisë së shërbimit.

- Lidhur me standardet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sikurse shprehur më sipër, ndërmjet ERE-s, OSSH sh.a. dhe përdoruesve të rrjetit/palëve të interesuara, ka pasur komunikime shkresore të vazhdueshme. OSSH sh.a., në vijim të komunikimeve me shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, ndër të tjera, ka përcjellë bashkëlidhur treguesit e cilësisë së shërbimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit për periudhën janar 2020 – dhjetor 2020.

- Lidhur me treguesit e standardeve të cilësisë në rrjetin e shpërndarjes, sqarojmë si më poshtë:

- Energjia e pafurnizuar (ENS): OSSH sh.a. këtë tregues, në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, e ka paraqitur në vlerën 51,246.00 mwh. Treguesi mund të llogaritet dhe të vlerësohet nga OSSH sh.a., për faktin se kjo shoqëri ka informacionin e nevojshëm lidhur me ndërprerjet,



kohëzgjatjen e tyre dhe numrin e konsumatorëve, të cilët kanë mbetur pa furnizuar me energji elektrike për atë periudhë kohore. Për rrjedhojë, treguesi ENS, për vitin 2021, të jetë minimalisht në vlerën e paraqitur nga OSSH sh.a., me shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, në sasinë prej 51,246.00 mwh.

- Cilësia e frekuencës (FQ): Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 100, datë 26.8.2008, ka miratuar Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, i cili aktualisht mbetet i vetmi dokument i miratuar nga ERE, që përcakton rregullat, normat, procedurat dhe kërkesat teknike për OSSH sh.a., dhe përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes, të cilët ndërtojnë marrëdhëniet midis tyre duke u bazuar në këtë kod. Gjithashtu, rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181/2017, në pikën 2.2, të nenit 2, përcakton se: “OSSH ka detyrimin e shërbimit publik që të përmbushë kriteret standarde të cilësisë së furnizimit, të specifikuar nga Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes dhe kjo rregullore”. Për rrjedhojë, treguesi FQ, për vitin 2021, të jetë sipas përcaktimeve të Kodit të Shpërndarjes, të shprehura në nënpykat “ii” dhe “iii”, të pikës II.6.1.

- Cilësia e tensionit (VQ): nivelet e tensionit në sistemin e shpërndarjes janë: 230 V, 400 V, 6,3 kV, 10 kV, 20 kV, 35 kV, 110 kV (pa përfshirë linjat 110kV). OSSH sh.a. këtë tregues, në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021 e ka paraqitur të ndarë dhe të matur veçmas për tri kategori: i) urbane ku devijimet e tensionit janë në diapazonin + 6%, - 22%; ii) rurale ku devijimet e tensionit janë në diapazonin +10%. - 20%; dhe iii) rurale e thellë ku devijimet e tensionit janë në diapazonin +13%, - 30%. Sipas të dhënave të raportuara nga OSSH sh.a., në zonat rurale të thella tensioni shkon në - 30%, nga vlera e tij nominale. Për rrjedhojë, treguesi VQ, për vitin 2021, të jetë në përputhje me rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181/2017, të jenë ato të përcaktuara në pikën II.6.2, të Kodit të Shpërndarjes.

- Koha e nevojshme për kërkesat për lidhjet e reja: Bordi i ERE-s ka miratuar, me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, rregulloren “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”. Kjo rregullore përcakton procedurat, kriteret, afatet dhe çdo element tjetër të nevojshëm në aplikimet për lidhje

të reja apo modifikim të lidhjeve ekzistuese në rrjetin e shpërndarjes. Për rrjedhojë, treguesi koha e nevojshme për kërkesat për lidhjet e reja, për vitin 2021, të jetë ai i përcaktuar në rregulloren “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, sipërcituar.

- Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve (SAIDI): OSSH sh.a., këtë tregues, në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, e ka paraqitur si vlera të realizuara për vitin 2020. SAIDI për total rrjetin e shpërndarjes, në vlerën 44.12 orë; për zonat urbane 16.2 orë, për zonat rurale 77.73 orë dhe zonat rurale të thella 102,33 orë. Treguesi SAIDI, në respekt të rregullores së miratuar me vendimin e Bordit nr. 181/2017, do të merret vlera e arritur për total rrjetin e shpërndarjes i cili përfshin jo vetëm ndarjen zonale, por edhe përbërjen e rrjetit të shpërndarjes në nivele tensioni.

Vlera e SAIDI-t për TU-në, e realizuar për vitin 2020, sipas OSSH sh.a., është 3.05 orë. Në këtë kontekst, vlera e realizuar e SAIDI-t në total rrjetin e shpërndarjes, ku përfshihen gjithë nivelet e tensionit në administrim të OSSH sh.a., për vitin 2020, e raportuar me shkresat e sipërcituara, është 47.17 orë.

Për rrjedhojë, treguesi SAIDI, për vitin 2021, të jetë 47.17 orë.

- Indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjeve (SAIFI): ERE, nëpërmjet shkresës nr. 304 prot., datë 11.2.2021, ka kërkuar nga OSSH sh.a. paraqitjen e treguesve për gjithë nivelet e tensionit të rrjetit të shpërndarjes në zbatim të përcaktimeve ligjore të sipërcituara. Vlera e SAIFI-t për TU-në e realizuar për vitin 2020, sipas OSSH sh.a., është 2.15. Në këtë kontekst, vlera e realizuar e SAIFI-t në total rrjetin e shpërndarjes, ku përfshihen gjithë nivelet e tensionit në administrim të OSSH sh.a. për vitin 2020 është 25.08. Për rrjedhojë, treguesi SAIFI-t, për vitin 2021, të jetë 25.08.

- Koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike pas një defekti në sistemin e shpërndarjes: OSSH sh.a., në zbatim të përcaktimeve të rregullores së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181/2017, e ka raportuar këtë tregues në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021. Duke qenë se këto vlera janë deklaruar nga vetë OSSH sh.a., si të realizuara për vitin 2020, dhe duke marrë në konsideratë faktin se ky tregues propozohet të miratohet për herë të parë sipas përcaktimeve të rregullores, sipërcituar,



konsiderohen si vlera të pranueshme për t'u aplikuar edhe për vitin 2021, për këtë tregues. Për rrjedhojë, treguesi koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike pas një defekti në sistemin e shpërndarjes, për vitin 2021, të jetë: për rrjetin e shpërndarjes TM + TU 2.78 orë, rrjeti 35 kV në zonë urbane 1.73 orë, në zonë rurale 1.77 orë. Rrjeti 20 kV në zonë urbane 1.34 orë, zonë rurale 1.70 orë, rrjeti 6 – 10 kV në zonë urbane 2.54 orë, zonë rurale 2.74 orë, rrjeti 0.4 kV në zonë urbane 1.07 orë, në zonë rurale 1.5 orë.

- Koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit: OSSH sh.a., në zbatim të përcaktimeve të rregullores së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181/2017, e ka raportuar këtë tregues në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, të realizuar në afatin kohor 13 ditë. Treguesi koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit, për vitin 2021, të jetë ai i përcaktuar në rregulloren “Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 145, datë 18.9.2017, jo më vonë se 5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës.

- Koha e nevojshme për t'u përgjigjur ankesave: OSSH sh.a., në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, nuk ka paraqitur informacion lidhur me këtë tregues. Duke qenë se në këtë tregues përfshihen dhe ankesat që kanë lidhje me matjen dhe nënkuptohet periudha kohore (në ditë ose orë) ndërmjet kohës kur është bërë ankesa për matjen (matës i thyer, mungesë matësi, mospajtim me vlerat e konsumuara, etj.) një bazë e mirë si referencë është rregullorja “Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 145, datë 18.9.2017. Në këto kushte, treguesi koha e nevojshme për t'u përgjigjur ankesave, për vitin 2021, të jetë ai i përcaktuar në rregulloren, sipërcituar, jo më vonë se 5 ditë punë prej ditës së paraqitjes së ankesës.

- Koha e nevojshme për të rilidhur klientët të cilëve u është ndërprerë energjia elektrike për shkak të detyrimeve të papaguara: OSSH sh.a. e ka

raportuar këtë tregues në afatin kohor 13 ditë. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 15, datë 10.1.2018, ka miratuar “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”. Në nenin 15 “Pasojat e mospagesës”, pika 15.1, përcaktohet si vijon:

“Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës, brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë, sipas nenit 13.1, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit, 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48-orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të klientit”.

Në këto kushte, treguesi koha e nevojshme për të rilidhur klientët të cilëve u është ndërprerë energjia elektrike për shkak të detyrimeve të papaguara, për vitin 2021, të jetë ai i përcaktuar në kushtet e përgjithshme të kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për klientët fundorë, miratuar me vendimin nr. 15, datë 10.1.2018, brenda 48-orësh nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të klientit.

- Koha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e shpërndarjes: OSSH sh.a., këtë tregues, në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, e ka paraqitur të paplotësuar. Bordi i ERE-s, me vendim nr. 255, datë 21.12.2020, miratoi treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021. Në këtë vendim ky tregues është përcaktuar 72 orë. Duke marrë në konsideratë faktin se OST sh.a. dhe OSSH sh.a. janë të dy operator rrjeti dhe ky parametër është i përcaktuar për OST sh.a., vlerësojmë se dhe për OSSH sh.a. ky parametër duhet të ketë të njëjtën vlerë. Në këto kushte, ky tregues të jetë 72 orë.

- Zgjidhja e ankesave për cilësinë e tensionit: OSSH sh.a. nuk e ka raportuar këtë tregues në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, në këto kushte vlerësohet se treguesi zgjidhja e ankesave për cilësinë e tensionit, duhet të trajtohet konform rregullores “Për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, si dhe të raportohet i ndarë si për zonat urbane dhe ato rurale. Në këto kushte, treguesi zgjidhja e ankesave për cilësinë e tensionit, për vitin 2021, të jetë ai i përcaktuar në



rregulloren “Për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

- Përqindja e klientëve aktualisht me matës: OSSH sh.a. nuk e ka raportuar këtë tregues në shkresën nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, por kjo rubrikë është paraqitur vetëm me simbolin %. Gjithsesi, OSSH sh.a. raporton në mënyrë periodike pranë ERE-s për treguesit, në të cilin përfshihet edhe ky tregues. Të dhënat evidentojnë që nuk kemi klientë, të cilët aktualisht janë pa matës të energjisë elektrike. Duke vënë re që numri i klientëve ndryshon në mënyrë dinamike, sikurse evidentohej në tabelë, për shkak të hapjes dhe të mbylljes së kontratave respektive, ky tregues nuk mund të jepet në vlera absolute, por në vlera relative. Në këtë kontekst, përqindja e klientëve aktualisht me matës është 100 %. Në këto kushte, treguesi përqindja e klientëve aktualisht me matës, për vitin 2021, të jetë ai i paraqitur në raportime nga OSSH sh.a., 100%.

- Hyrja në fuqi e treguesve të cilësisë bazuar në rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181/2017. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 255, datë 21.12.2020, vendosi miratimin e treguesve të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021. Për rrjedhojë, për t’iu dhënë mundësi si Operatorit të Rrjetit OSSH sh.a., si përdoruesve/konsumatorëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të marrin masat e nevojshme operative, për të operuar sistemet apo pajisjet e tyre me kushtet e reja të miratimit të standardeve të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes, gjykohej që këto standarde të hyjnë në fuqi menjëherë, por aplikimi i pikës 7.2, në nenin 7, të rregullores së miratuar me vendimin e Bordit nr. 181, datë 10.11.2017, të pezullohet për një afat nga miratimi i këtyre treguesve, deri më 31 gusht 2021. Kjo pikë të ketë efekte të plota juridike për periudhën nga 1 shtatori 2021 e në vijim. Periudha e mësipërme do të shërbejë për të akomoduar dhe njohur të gjitha palët, ku përfshihet Operatori i Rrjetit OSSH sh.a. dhe përdoruesit e tij me këta tregues të miratuar, si dhe për të marrë masat e nevojshme operative, me qëllim minimizimin e ndikimit të këtyre treguesve në operimin e sistemeve përkatëse.

Për sa i përket shkresës së shoqërisë OSSH sh.a., me nr. prot. 9626/3, datë 1.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 523, datë 6.4.2021, “Lidhur me treguesit e cilësisë së shpërndarjes së energjisë elektrike”, vlerësojmë se parashtrimet e shoqërisë janë marrë në konsideratë dhe trajtuar në procedurën përkatëse lidhur me këtë vendimmarrje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes (sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur).

2. Të pezullohet zbatimi i pikës 7.2, të nenit 7, të rregullores “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, për një afat deri më 31 gusht 2021, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Efektet juridike të pikës 7.2, të rregullores sipërcituar, do të fillojnë në datën 1 shtator 2021.

3. OSSH sh.a. të raportojë në ERE, çdo 3 (tre) muaj, mbi ecurinë e zbatimit të treguesve të matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes, për vitin 2021.

4. Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes do të jenë objekt i rishikimit, konsultimit dhe miratimit, me iniciativën e ERE-s ose me propozimin e OSSH sh.a. dhe çdo pale interesi.

5. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Standardeve të njoftojë OSSH sh.a. dhe palët e interesit në lidhje me vendimin e Bordit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



Tabela nr. 1

Treguesit	Niveli i pritshëm i performancës		
Energjia e pafurnizuar (ENS)	51, 246. 00 MWh		
Cilësia e frekuencës (FQ)	•Kufiri normal i operimit: 49.8 deri 50.2 Hz. •Gjatë çrregullimeve të sistemit: 48.0 deri 52.0 Hz.		
Cilësia e tensionit (VQ)	Nominal	I ulët	I lartë
	230 V	- 10 %	+ 5 %
	400 V	- 10 %	+5 %
	6 000 V	- 5 %	+ 5 %
	10 000 V	- 5 %	+ 5 %
	20 000 V	- 5 %	+ 5 %
	35 000 V	- 5 %	+ 5 %
	110 000 V	- 5 %	+ 5 %
Koha e nevojshme për kërkesat për lidhjet e reja	-Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 <i>kw</i> në TU. - Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 10-20 <i>kw</i> n <i>kw</i> TU. -Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 21-50 <i>kw</i> n <i>kw</i> TU. -Jo më shumë se 60 ditë pune për fuqi të instaluar 50-100 <i>kw</i> n <i>kw</i> TU. -Jo më shumë se 60 ditë pune p <i>kw</i> r lidhje n <i>kw</i> TM.		
Periudha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e shpërndarjes	72 orë		
Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve (SAIDI)	SAIDI = 47.17 orë		
Indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjeve (SAIFI)	SAIFI = 25.08		
Koha e nevojshme për Rikthimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike pas një defekti në sistemin e shpërndarjes	TM + TU 2.78 orë Rrjeti 35 kV zonë urbane 1.73 orë, në zonë rurale 1.77 orë. Rrjeti 20 kV në zonë urbane 1.34 orë, zonë rurale 1.70 orë, rrjeti 6 –10 kV në zonë urbane 2.54 orë, zonë rurale 2.74 orë, rrjeti 0.4 kv në zonë urbane 1.07 orë, zonë rurale 1.5 orë		
Koha e Nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit.	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës		
Koha e nevojshme për t'u përgjigjur ankesave, që kanë lidhje me matjen	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së ankesës		
Koha e nevojshme për të rilidhur klientëve të cilëve u është ndërprerë energjia elektrike	Brenda 48 orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të klientit		
Zgjidhja e ankesave për cilësinë e tensionit	30 ditë kalendarike		
Përqindja e klientëve aktualisht me matës	Përqindja e klientëve aktualisht me matës është 100%, e numrit të klientëve		

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë